II-642

ÇESHTJA KOMBTARE

SERI ARTIKUJSH

1946

KOMITETI KRAHINUER I PKJ TE KOSMETIT

Çeshtja Kombtare

— seri artikujsh —

Arab. cf. 1617

1945

KOMITETI KRAHINUER I PKJ. TË KOSMETIT

ОБЛАСНА НАРОДНА БІБЛІОТЕКА
BIBLIOTEKA POPULLORE
BIBLIOTEKA POPULLORE

Çka asht kombi?

Kombi asht, ma parë se gjithshka, nji komunitet i caktuem individësh. Ky komunitet nuk asht as racet as fisit. Kombi i tashem italian asht i formuem prej Romanësh, Gjermanësh, Etrurësh, Arabësh etj. Po kjo duhet të thuhet edhe për Englezët, Gjermanet etj. të formuem si kombe me njerëz, të cilët u përkasin racave dhe fiseve të ndryshme. Kështu pra kombi nuk asht as komunitet race as fisit, por nji komunitet njerzisht i ardhun (i formuem) historikisht. Nga ana tjetër s'ka dyshim se shtete të mdha si ato të Kirit dhe t'Aleksandrit, nuk mund të quhen kombe, ndonse te formueme historikisht nga raca dhe fise të ndryshme. Kto nuk kanë qenë kombe por konglomerate të grupeve të rastësishme e me lidhje të dob'a në mes të tyne, qi janë dekomponue ase bashkue mbas suksesit ase disfates së këtij ase atij zaptuesi. Pra kombi nuk asht konglomeratë e rastësishme dhe e paqindrueshme. porse nji komunitet i qindrueshëm njerzish. Po me gjith këte, komuniteti i qindrueshëm nuk përban kombin. Austrija dhe Rusija, edhe këto janë komunitete të qindrueshme, por prap se prap askush nuk i quen kombe.

Çka e dallon komunitetin kombtar nga ay shtetnuer? Nder faktorët e tjerë asht edhe ky: komuniteti kombtar nuk mund të mendohet pa nji gjuhë të përbashkët, nëdr-

sa për shtetin gjuha e përbashkët nuk asht e demosdoshme. Kombi çek n'Austri dhe ay polak në Rusi, kanë qenë të pamundun pa nji gjuhë të perbashkët për seicilin prej këtyne, kurse ekzistença e gjithë asaj serije gjuhësh mbrenda Rusis dhe Austris pengon unitetin, e këtyne shtetevet. Natyrisht, këtu e kemi fjalen për gjuhët popullore (kombtare) dhe jo për ato zyrtare administrative.

Pra, nji nder shenjat karakteristike te Kombit asht gjuha e përbashkët.

Por kjo nuk don të thotë aspak se kombe të ndryshme flasin gjithmonë dhe kudo gjuhë te ndryshme ase që të gjithë ata qi flasin të njajtën gjuhë duhet të përbajnë pa tjetër nji komb. Çdo komb duhet të ketë nji gjuhë të përbaskët, por nuk asht e dosmosdoshme që kombë të ndryshme të kenë edhe gjuhë të ndryshme. Nuk ka komb qi flet njikohësisht ma tepër se nji gjuhë, por kjo nuk don me thanë se nuk mund të jenë dy kombe qi të flasin të njajtën gjuhë. Englezët dhe Veri Amerikanët flasin të njajtën gjuhë, por me gjith kte nuk përbajnë të njajtin komb. Kte mund t'a themi gjithashtu edhe për Norvegjezët e Danezët, Anglezët dhe Islandezët. Englezët dhe Veri-Amerikanet, fjala vjen, nuk janë nji komb, me gjith se e kanë gjuhën e përbashkët, së pari, sepse ata nuk jetojnë pranë njeni tjetrit, por në territore të ndryshëm. Kombi vjen si rezultat i marrëdhanjeve të vazhdueshme dhe të rregullshme, si rezultat i jetes së përbashkët të njerëzvet, prej gjeneracjoni në gjeneracjon. Pra, nji jetë e gjatë në komunitet asht e pamundun pa nji territor të perbashkët. Dikur Anglezët dhe Amerikanet banojshin në te njajtin territor, n'Angli, dhe ishin nji komb.

Mandej, nji pjesë e Anglezëvet emigroi prej Anglije ne territorin e ri, n'Amerikë, dhe, me kohë, në ketë territor të ri, u-formue kombi i ri Veri-Amerikan. Ndrrimi i territoreve shkaktoi formimin e kombevet të ndryshëm.

Pra, Komuniteti i territorit asht nji nder shenjat karakteristike te kombit.

Por kjo akoma nuk mjafton. Vetëm komuniteti i territorit, në vet-vehte, nuk e ban kombin. Në mes te tjerash, per kte, duhet t'ekzistojë edhe lidhja e mbrendëshme ekonomike, që bashkon pjesët'e ndryshme të kombit ne nji *copë të njisueme.* Nji lidhje e këtillë nuk ekziston në mes Anglis dhe Amerikës së Veriut, prandaj kto formojnë dy kombë të ndryshme. Por Amerikanët nuk do te meritojshin me u thirrë komb, sikur pika te ndryeshme të Amerikës së Veriut mos t'ishin te lidhuna ne nji tensi ekonomike, me anë te ndamjes së punës në mes tyne, me zhvillimin e rrugëvet të komunikacjonit etj.-etj. T'i marrim per shembull Gjeorgjianët. Para reformës, ata jetojshin ne nji territor të përbashkët dhe flitshin nji gjuhë, por, me gjith kte nuk përbajshin nji komb, me kuptimin e plotë të fjalës. Ishin te ndamë nder shum principata të veçueme nga njena tjetra; nuk muejshin me jetue nji jetesë ekonomike te përbashkët; luftojshin nder vedi dhe asgjasojshin njeni tjetrin, tue i nzitë kundra shoqi shojt herë. Persjanët e herë Turqët. Principatët jetëshkurta, të bashkueme ndonji herë rastësisht, prej ndonji mbreti fatlum, ma te shumtën e herës përfshijshin sferen administrative, per t'u shëndrue shpejtë per hir të kapriceve të princavet dhe te indiferencës së fshatarit. Tek e mbramja, kjo as që mund, t'ishtë ndryshej, tue

marrë parasyshë përçamjen ndermjet Gjeorgjanëvet. A u-çfaqen si komb në gjymsen e dytë të shekullit të 19:t kur merr fund edhe skllavnija. Përparimi i jetës ekonomike, zhvillimi i rrugëvet te komunikacjonit, dhe lindja kapitalizmit vendosen ndamjen e punës ne mes te krahinavet gjeorgjane dhe tronditen perfundimisht izolimi ekonomik te principatavet, per t'i bashkue ne nji tanësi. E njajta gja duhet thanë edhe per kombët e tjerë, q kanë kalue fazen e feudalizmit dhe kane zhvillue tek at kapitalizmin.

Pra, jeta ekonomike e perbashkët, kohezjoni ekonomik asht nji nder veçoritë karakteristike te kombit. Por edhe kjo akoma nuk mjafton. Përveç këtyne qi thamë, duhen marrë parasyshë edhe veçorit e psikologjis së njerzvet të bashkuem në nji komb. Kombet npryshojnë njeni nga tjatri jo vetëm në bazë të kushteve të jetesës, por gjithashtu edhe mbas mentalitetit të tyne, i cili shprehet në veçorit e kulturës kombtare.

Që Anglja, Amerika e Veriut dhe Irlanda, të cilat flasin të njajten gjuhë, të perbajnë prap se qrap, me gjithë kte, tri kombë të ndryshme, kjo gja i kushtohet rolit te randësishëm qi ka luejtë formimi psihik, që asht trajtue, në saje të kushteve te ndryshme t'ekzistencës, brez mbas brezi. Kuptohet kjartazi se formimi psihik në vetvehte, ose, si mund t'a thrrasim ndryshej, „karakteri kombtar", i paraqitej vrejtuesit si nji gja e pa kuptueshme. Por, deri sa ay shprehet në origjinalitëtin e kulturës së perbashkët të kombit, asht nji gja e dukëshme dhe nuk mund të mohohet. Nuk asht nevoja t'a thekësojmë aqë, se „karakteri kombtar" nuk asht nji send i vendosun nji herë e

pergjithmonë, por ndrron, bashkë me kushtet e jetes; sido qoftë deri sa ekziston në çdo moment të dhanun, ai len gjurmën e vet në fizjonomin e kombit.

Pra, formimi i perbashkët psihik, qi shprehet në kulturen e perbashkët asht nji nder shenjat karakteristike të kombit.

Në ket mënyrë ne i kemi vue rë dukje të gjitha shenjat qi karakterizojnë kombin.

Kombi asht nji komunitet i qindrueshem, i formuem historikisht, komunitetet gjuhe, territori, jete së perbashkët dhe formimi psihik, qi shprehet në kulturen e perbashkët.

Nga kjo rjedhë se kombi, si çdo çfaqje e fortë historike i nënshtrohet ligjit të ndryshimit, dhe ka historin e vet, fillimin dhe mbarimin e vet.

Asht nevoja të theksohet se nji nga shenjat e permendun, i marrun vetmas, nuk asht i mjaftueshem per percaktimin e kombit, ose ma mirë me thanë mungesa e vetem njenit prej këtyne shenjave asht e mjaftueshme që kombi të pushojë së qënuri komb. Mund te mendojmë njerëz që të kenë edhe karakterin Kombtar të perbashkët e prap se prap nuk mund të themi se perbajnë nji komb, po qe se janë të veçuem ekonomikisht po qe se jetojnë në territore të ndryeshëm, po qe se flasin gjuhë të ndryshme, e tj. Të këtillë janë per shembull Çifutet (rusë, galicjanë, amerikanë, gjeorgjanë dhe ata të maleve të Kaukazit), të cilët, simbas mendimit t'onë, nuk formojnë nji komb të vetem.

Mund të marrim me mend njerëz, të cilët e kanë jeten ekonomike e territorin e perbashkët, por me gjithë

këte nuk perbajnë nji komb, po qe se nuk kanë gjuhen dhe „karakterin kombtar" të perbashkët. Të këtillë janë per shembull Gjermanët dhe Letonët në vendet baltike. Së fundi, Norvegjezet e Danezët flasin nji gjuhë të perbashkët, por kjo nuk don me thanë se formojnë nji komb; mbasi u mungojnë shenjat tjera. Vetem sinteza e të gjithë shenjave të marrun së bashku na japin kombin.

Mund te duket se „karakteri kombtar" nuk asht nji nder shenjat serjoze, por nji veçori esencjale e kombit e jo nji karakteristikë e tij. Ket pikpamje, përsh. e përkrahin teoricjenët socjal-demokratë të çashtjes kombtare,

Asht i njoftun n'Austri K. SPRINGER dhe sidomos OTO BAUER. T'a shqyrtojmë teorin e tyne të kombit:

Si mbas Springer-it. kombi asht nji shoqni njerzish, qi mendojnë edhe flasin njisoj, asht „komuniteti kultural i nji grupi njerzish, qi nuk asht i lidhun me token. Pra, shoqni njerzish qi mendojnë edhe flasin njisoj, sado të ndamë qi të jenë nder vedi dhe kudo qi të jetojnë.

Bauer-i shkon edhe ma përtej: „Çka asht kombi? pyet ay. A asht gjuha e përbashkët ajo qi i bashkon ne nji komb? Mirë po Anglezet dhe Irlandezet flasin nji gjuhë e me gjithë këte nuk perbajnë nji komb. Çifutet nuk kanë hurrfarrë gjuhe të perbashkët e me gjithë këthot Bauer-prap se prap përbajnë nji komb. Po ç'asht kombi atëherë? Kombi asht nji komunitet i karakterit relativ. Po ç'asht karakteri-në kuptimin e karakterit kombtar? Karakteri kombtar asht mbledhje (shuma) e shenjavet me të cilat dallohen njerëzit e kombësis tjeter,

nji kompleks veçorish fizike dhe morale qi dallojnë nji komb nga tjetri". Sigurisht Bauer - i e din se karakteri kombtar nuk bjen prej qielli, e prandaj shton: „Karakterin e njerëzvet nuk e përcakton kurgja tjeter veçse jeta e përbashkët e percaktueme nga kushtet nga të cilat njerëzit prodhojnë mjetet e tyne t'ekzistencës dhe i ndajnë prodhimet e punës së tyne".

Pra kemi mbrijtë deri te kufizimi ma i pershtatshmi, thot Bauer - i.

„Kombi asht nji bashkim njerzish, qi mbshtillen rreth karakterit të perbashkët, në planin e fatit të përbashkët (simbas Bauer - it). Pra, komuniteti karakterit kombtar në planin e fatit, të përbashkët, të marrun pa lidhje të domosdoshme në ekzistencen e territorit, gjuhes dhe jetes ekonomike".

Po në këtë rasë çka i mbetet kombit? Për çfarë komuniteti kombtar mun të flitet për njerës ekonomikisht t'izoluem nder vedi, që jetojnë në territore të ndryeshme dhe flasin brez mbas brezi gjuhë të ndryshme?

Bauer - i thot për Çifutët se janë nji komb, me gjithë se nuk kanë kurrfare gjuhe të përbashkët. Po per çfarë fati të përbashkët, për çfarë kohezjoni kombtar mund të flitët në lidhje me Çifutet gjeorgjan, dagenstanez, kryekëput të ndamë njeni prej tjetrit, që jetojnë në territore te ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme? Çifutet për të cilët jemi tue ba fjalë pa dyshim e çojnë jetën ekonomike dhe politike bashkë me Gjeorgjanët, Dagestanët, Ruset dhe Amerikanët në nji atmosferë kulture të përbashkët per seicilin prej këtyne kombevet, gja që len pershtypjen e vet në karakterin e tyne kombtar. Dhe në se

u ka mbetë diçka e përbashkët, kjo asht feja, origjina tyne e perbashkët dhe disa mbeturina të karakterit tyne kombtar. Të gjitha kto janë të pamohueshme. Po si mund të pohojmë seriozisht që ceremonitë fetare t fosilizueme dhe mbeturinat psikologjike te cilat po zhd ken, të influencojnë mbi fatin e Çifutëve të naltpërmen dun ma fort se ambjenti i gjallë shoqnuer, ekonomik kultural që i rrethon? Nga kjo rjedhë së, tue u nisë ng kjo pikëpamje, mund të themi se Çifutet përgjithësish janë nji komb.

— Atëhere, çka e dallon kombin Bauer-jan ng „shpirti komb'ar", mistik e i mjaftueshëm per vetvedi nji spiritualisti?

Bauer-i shenon nji kufi të pakalueshëm ne mes të „shejit dallues" të kombit (karakterit kombtar) dh kushteve të jetës së tij, tue i nda njenin prej tjetrit. Por, çka asht karakteri kombtar, në se nuk asht refleksi i kushteve të jetës, në se nuk asht mbledhja e pershtypjevet të marruna nga ambjenti rrethues; si mund të kufizohemi vetëm në karakterin kombtar tue e izolue këte nga terreni që e ka perfitue?

Pastaj, po t'a marrim si duhet, ç'ka e dallon kombin Anglez nga ai Veri amerikan, kah mbarimi i shekullit 18-të e kah fillimi i shekullit të 19-të, kur Amerika e Veriut hala thirrej „Angli e re"? Sigurisht jo karakteri kombëtar, pse Amerikanët e Veriut janë me origjinë angleze. Ata kanë marrë me vehte n'Amerikë, pervëç gjuhës angleze edhe karakterin kombëtar anglez, të cilin sigurisht nuk kanë mujtë me e humbë aqë shpejt, me gjithë se nën influencën e kushtevet të reje pa tjetër tek ata asht

formue nji karakter i veçant. E pra, me gjithë karakterin pak a shumë të përbashkët, u krijue n'atë epokë nji komb i ndrueshem nga ay anglez.

Kyptohet vet vetiu se Anglija e re, komb, da lohej atëhere nga Anglija, si komb, jo për karakterin e vet të veçantë, por për ambjentin e vet të ndryshëm nga ay i Anglis, për kushtët e ndryshmë të jetës.

Kendej kuptohet pra kjartas se në të vertetë nukka për kombin vetem nji shej dallues, porse nji sasi shejash, prej të cilve, kur bajmë krahasimin e kombevet, bjen në sye herë njeni (karakteri kombtar) herë tjetri (gjuha), herë i treti (territori), lidhja ekonomike etj.

Kombi asht kombinimi i ketynë shejavet të marruna së bashku.

Pikëpamja e Bauer-it, e cila identifikon kombin me karakterin kombtar, e ndan kombin nga truelli dhe e ban ate nji farë fuqije të pa dukshme, e cila i mjafton vetvehtes. Ç'prej këtij momenti nuk kemi ma nji komb të gjallë, veprues, por se diçka mistike, të pa kuptueshme, të vdekun.

Sepse, përsëris, ç'asht për shëmbullë ai komb Çifut, i përbam prej Çifutësh gjeorganë, dagestaneze, rusë, amerikanë e tjerë, antarë e te cilit nuk mirren vesht ndër vedi (flasin gjuhë të ndryshme), jetojnë ndër vende të ndryshme të lamshit toksuer, kurkund nuk do të shifen, nuk do të punojnë kurrë së bashku, as në kohë paqe as në kohë lufte?

Jo, për kombet të këtilla, të cilat ekzistojnë vetem në letër, socjal demokracija nuk e ka caktue programin e vet kombtar; ajo merrë parasysh vetëm kombet që

ekzistojnë që veprojnë, që lëvizin e që, bash per këto arsye, i detyrojnë të tjerat që t'i marrin parasysh.

Duket kjartas se Bauer-i e perzien kombin, si kategori historike, me fisin si kategori etnografike. Tek e mbrambja s'ka dyshim se vet Bauer-i e kupton dobësinë e tezave të veta, mbassi në fillimin e librit të vet i ka shpalle me kambëngulje Çifutet si komb, Bauer-i korrigjon vetvehten kah fundi i librit të tij, tue pohue se shoqnija kapitaliste nuk i lejon ata të qendrojnë si komb dhe i asimilon në kombe te tjera.

Duket se shkaku i kësaj gjaje asht se Çifutet nuk kanë nji territor të kufizuem per banim, ndersa nji territor i këtill ekziston, p sh. per Çekët, të cilët, simbas Bauer-it duhet të mbahen si komb Tue arsyetue kështu ka dasht me tregue se autonomija kombëtare nuk mund të jetë kerkesë e puntorve Çifutë, por si me këtë faktë e ka rrëxue, pa dasht, vet teorin e tij, e cila mohon territorin e perbashhët, si nji shej të kombit. Por Bauer-i shkon ma pertej, Në fillimin e librit të vet ai deklaron kambëngultas se Çifutët nuk kanë nji giuhë të perbashkët e me gjithë këte bajnë nji komb. Por, sa mbërrin në faqën 38-të, ndërron pllaken dhe po me atë kambëngulje deklaron: „S'ka dyshim se asnji kombë s'asht i mundun pa nji gjuhë të perbashkët..." Bauer-i ka dasht me tregue këtu se „gjuha asht mjeti ma i randësishem per marrëdhanjet në mes të njerëzvet". Por njikohësisht ai ka vertetue, pa dasht, edhe ate që nuk e ka pasë nder mendë m'e tregue, don me thanë vet falimentimin e teoris së tij mbi kombin, e cila mohon randësin e gjuhës së perbashkët. Kështu, kjo teori, e qindisun me fije idealizimit, rrëxon vet-vehten.

Çka âsht „Levizja kombtare"

...Kombi nuk asht vetëm kategori historike, por kategori historike e nji epoke të caktueme, epokës së kapitalizmit në formim e sipër. Proçesi i likuidimit të feudalizmit dhe zhvillimit të kapitalizmit esht njikohësisht edhe proçes i bashkimit të njerzve ne komb. Kështu kanë ngja punët, b f. n'Europën Perëndimore. Anglezët, Frarcezët, Gjermanët, Italjanët dhe popujt e tjerë si këta janë bashkue në kombe në kohën e sulmit gadhnjimtarë të kapitalizmit mbi feudalzmin në dekomponim.

Por formimi i kombeve do të thonte njikohësisht edhe kthimin e tyne në shtete kombëtare në vehte. Anglija, Franca e kombet e tjera çfaqen njikohësisht si shtetë kombëtar Anglez, Frances etj. Irlanda, që kanë ngelë mbrapa në këte proçes, nuk ndryshon pamjen e përgjithshme.

N'Europën lindore punët kanë ngja dishka ndryshe. Në kohën kur në Perëndim kombët zhvillohen si shtete kombëtare, në Lindje formohen shtete shumë kombesh, që përbahen prej disa kombeve. Të këtilla janë, b f. Austro-Hungarija e Rusija. N'Austri, Gjermanët janë tregue si ma të zhvilluemit politikisht e prandaj kanë marrë mbi vehte vepren e bashkimit të kombeve austrieke në nji shtet. Në Hungari, Hungarezët u treguen si ma të zotët per organizim shtetnuer, prandej u bane qendra e kom-

beve Hungareze dhe qenë bashkuesat e Hungarisë! Në Rusi, rolin e bashkuesit të kombeve e muren mbi vehte Rusët e Mëdhaj, që në krye të tyne kishin burokracinë e fuqishme e t'organizueme ushtarake t'Oborrit, historikisht të formueme.

Kështu kanë ngja punët në lindje.

Kjo mënyrë e veçantë e formimit të sheteve ka mujtë me ndodhë vetem nën kushtet e feudalizmit ende të pa-likuiduem, nën kushtet e kapitalizmit pak të zhvilluem, kur kombet, të hedhun në rend të dytë, hala nuk ja kishin arritë me u perforcue ekonomikisht si kombe të plota.

Por edhe në Shtetet Lindore kapitalizmi nis të zhvillohet. Zhvillohet tregtija, zhvillohen rrugët e komunikacjonit. Lindin qytete të mëdhaja. Kombet forcohen ekonomikisht. Tue ndërhye në jetën paqsore të kombeve të nënshtruem, kapitalizmi i zgjon këta dhe i fut në lëvizje. Zhvillimi i shtypit dhe theatrit, puna e Këshillit të Raich-ut (n'Austri) dhe i Dumes (në Rusi) i jep shkas forcimit të „ndjenjave Kombtare". Kategorija intelektuale e posa lindun e këtyne kombeve rrëmbehet nga „Ideja kombëtare" dhe tepron n'atë drejtim...

Por kombet e shtypunë, edhe pse zgjohen me nji jetë në vehte, prap se prap ende nuk janë zhvillue si shtete kombëtarë të pa-mvarunë dhe në rrugën e tyne ndeshin qëndresën e fortë të shtresave drejtuese t' atyne kombeve që zotnojnë e që kaherë janë vue në krye të shtetit. Këtyne u ka dalë gjumi vonë!...

Kështu, n'Austi, formohen si kombe Çekët, Polonezët etj.; në Hungari Kroatët e tjerë; Në Rusi, Letonët, Litu-

anët,Ukrainasit, Gruzinët, Ermenët etj. Çka ishte përjashtim për Europën Perëndimore (Irlanda), në Lindje bahet rregull. Në Perëndim, gjendjes së sajë të përjashtueshme, Irlanda iu përgjegj me lëvizjen kombëtare. Në Lindje, kombeve të zgjueme ju desht me u përgjegjë po me atë mënyrë.

Këto qen rrethanat që ju kanë dhanë shkas per luftë kombeve të reja të Lindjes europjane.

Lufta ja nisi dhe u perhap, por jo në mes të kombeve si tanesi, veç në mes të klasave sunduese të kombeve zotnues, nga nji anë, dhe të kombeve të shtypunë nga ana tjeter. Zakontsht. luften e drejton ase mikroborgjezija qytetere e kombit të shtypun kundra borgjezis së madhe të kombit zotnues (p.sh. Çekët e Gjermanët), ase borgjezija fshatare e kombit të shtypun kundra pronarëve të mëdhaj të kombit sundues (p.sh. Ukrainët në Poloni) ase e gjithë borgjezija „kombëtare" e kombeve të shtypun kundra klikes sunduese të kombit zotnues (p.sh. Polonija, Lituanija e Ukraina në Rusi).

Rolin kryesuer e luen borgjezija.

Per borgjezin e ré, çeshtja kryesore asht tregu. Me e shitë mallin e vet e me dalë fituese në konkurencen me borgjezin e huej, ky asht qellimi i sajë. Prej këndej, dëshira a sajë për t'i sigurue vehtes tregun „e vet të natyrshem". Tregu asht shkolla e parë ku borgjezija mëson nacjonalizmin.

Por, zakonisht, puna nuk mbaron me tregun. Në luftë përzihet burokracija gjysëm feudale, gjysëm borgjeze e kombit sundues me methodhat e sajë „mbajë" e „mos e lësho". Borgjezija e kombit sundues, qoftë ajo

e madhja ase e vogla, gjen mundësinë me i qirue „ma shpejtë" e „ma ven limtarisht hesapet me konkurentin e vet. Forcat bashkohen dhe, ja - fillon nji seri e tanë kufizimesh si masa kundra borgjezis së „huej", deri sa këto masa shëndrrohen në shtypje. Prej fushes ekonomike lufta kalon per së shpejti me ato politike. Mbi krye të „konkurentit" bijnë: kufizimi i liris së çdo perparimi, të ma tutjeshem, suprimimi i qjuhes, kufizimi i të drejtave të botimit, suprimimi i shkollave, presjoni fetar etj. Ma në fund, këto masa i kerkon jo vetem interesi i klasave borgjeze të kombeve zotnuese, por edhe qellimet specifike e, si me thanë, sektare të burokracisë në fuqi. Por, nga pikpamja e rezultateve, asht krejt nji: në këso raste, klasat borgjeze dhe burokracija shkojnë dorë per dore. ndash n'Austro - hungari ndash në Rusi.

E ngushtueme nga te gjitha anët, borgjezija e kombit të shtypun fillon natyrisht, me lëvizë. U banë thirrje „shtresave te veta „të veta kombtare" e ja nisë me bertit sa mundet për „atdhen", tue paraqitë punen e vet si punë të përgjithshma të popullit. Nder „bashkambasit e vet" rekruton armaten e vet n'interes... „t'atdheut". Dhe shtresat e ulta nuk tregohen gjithmonë të pa ndishme karshi këtyne thirjeve. Për mobilizimin e tyne rreth këtyne flamujve influencojnë shtypjet e naltpërmenduna, të cillat krijojnë pa - kënaqsi edhe ndër to.

Kështu fillon lëvizja kombëtare.

Fuqija e lëvizjes kombëtare përcaktohet me shkallen ne të cillën marrin pjesë shtresat e gjana kombëtare, proletarijati e katundarija.

A do të vehet proletarjati nën flamurin e nacjonalizmit borgjez? - Kjo mvaret nga faza e zhvillimit të kontraditave te klasës, nga vetëdija dhe organizimi i proletarijatit. Proletarijati i vetëdijshëm e ka flamurin e vet të sprovuem dhe s'ka pse hynë nën flamurin e borgjezisë.

Përsa i përkët katundarisë, pjesmarrja e saj në levizjen kombëtare mvaret, në rend të parë, nga karakteri i shtypjes. Po qe se shtypjet prekin n'interesin e „tokes", siç ka pas ngja në Irlandë, turma të gjana të katundarisë vehen me mji herë nën flamurin e lëvizjes kombëtare...

... Nën kushtet e kapitalizmit ne lulëzim, lufta kombëtare asht luftë ndërmjet klasave borgjeze. Diku borgjezija ja doli me shtie në lëvizjen kombëtare proletarijatin dhe atëhere lufta kombëtare, për keh dukja e saj e jashtëme ka karakter të „përgjithshëm populluer", por kjo vetëm në dukje të jashtëme. Në substancën e saj, lufta kombëtare mbetet borgjeze, luftë që kryesisht i sjellë dobi dhe i bjenë për lale borgjezisë.

Por kjo nuk don të thotë aspak se proletarjati nuk duhet të luftojë kundra politikes së shtypjes kombëtare.

Kufizimi i levizjes së lirë, mohimi i të drejtave te votës, të gjuhës; ndalimi i shkollave dhe shtypjet e tjera nuk u takojnë ma pak - në mos u takofshin ma shumë - puntorëve se sa borgjezis.

Nji gjendje e këtillë mundet vetëm t'a ndalojë zhvillimin e lirë të fuqive shpirtnore të proletarijatit të kombeve të shtypjunë. Asht e pa mundun me folë seriozisht mbi zhvillimin e plotë të prirjeve shpirtnore të puntorit Tartar ose Izraelit, deri sa nuk i lejohet me përdorë gjuhen e tij amtare ne mledhje e konferenca, deri sa i

mbyllet rruga e arsimit.

Por, për çashtjen e proletarjatit, politika e shtypjes kombëtare asht e rrezikshëme edhe nga nji pikpamje tjeter. Ajo largon vemendjen e turmave të gjana nga çashtjet shoqnore - çashtjet e luftës së klasës dhe e drejton kah çashtjet kombëtare - çashtje „të përbashkëta" të proletarijatit e të borqjezisë - gja që u len nji terren të përshtatshëm dekllaratave të rrejshme n bi „harmoninë e interesavet", lanjes në heshtje t'interesavet të klases të proletarijatit, robnimit shpirtnuer të puntorëve. Ne kete, bashkimit të puntorëve te të gjithë kombësive i vehet nji pengesë serioze. Nëse pjesa ma e konsiderueshme e puntorëve polonez deri sot e kësaj dite ka mbetë nen robnimin shpirtnuer të nacjonalistave borgjez nëse edhe sot e kësaj dite ka mbetë jashta lëvizjes puntore ndërkombetare, kjo rrjedhë kryesisht nga se politika e kahershme anti poloneze „pushteti ne duer të çifliqareve" jep nji terren të përshtatshem per nji robnim të këtillë, ban të vështirë çlirimin e puntorëve nga kjo robni...

Por politika e shtypjes nuk ndalet me kaq. Nga „sistemi" i shtypjes, ajo kalon shpesh në "sistemin" e dasis kombëtare, „sistemin" e therjeve, masakrimit e të çfarosjes. Ky sistem i fundit s'asht e mundun të zbatohet gjithnji dhe kudo, veç aty ku mundet - nen kushtet e mungesës së lirive ma elementare, atje ajo shpesh herë merr përjashtime të frikëshme dhe kercnon t'a mbys bashkimin puntorë në gjak e në lot. Në lidhje me këto, Kaukazi dhe jugu i Rusis na japin shumë shembuj. „Daj e sundo": ky asht qellimi i politikes së përçarjes. Dhe ne qoftë se kjo farë politike mbërrinë me u realizue, paraqet

rrezikun ma të madh për proletarijatin, pengesen ma serioze per bashkimin e puntorëve të gjitha kombësive të shtetit.

Kurse interesi i puntorëve kerkon bashkimin e plotë të të gjithë shokve të tyne n'ushtrine e unjisueme ndërkombëtare, çlirimin e tyne të shpejtë e definitiv nga robnimi shpirtnor i borgjezis, zhvillimin e plotë e të lirë të fuqive shpirtnore të bashk-vellazenve te tyne, çfardo kombësije qofshin.

Ky asht shkaku që puntorët luftojnë dhe kanë me luftue kundra politikes së shtypjes kombëtare, cilat do qofshin format në të cilat ajo paraqitet, nga ma të rafinuemet deri në ma trashaniket - si edhe kundra politikes se ndasis, në të gjitha çfaqjet e saja.

Ky asht shkaku për të cilin socjal-demokracija e gjitha vendeve shpallë të drejten e vetvendosjes kombëtare.

STALIN, *Marksizmi e çashtja kombëtare, 1913*

Mbi parashtrimin lenjiniste të çeshtjes kombtare.

Po marr nga kjo themë dy çeshtje kryesore: a) parashtrimi i çeshtjes, b) levizja çlirimtare e popujve të shtypun dhe revolucioni proletar.

Parashtrimi i çeshtjes. — Gjate njizet vjetve të fundit, çeshtja kombëtare ka pësue nji seri ndryshimesh shum të randsishme.

Tani, në gjanesinë e saj dhe ne karakterin e saj të mbrendshem, kjo ndryshon krejtsisht nga ajo çka ishte nën Nderkombëtaren e Dytë.

Atëherë ajo ishte e kufizueme krejtsisht në çështjen e ndryeshjes së kombësive „të qytetnueme" Irlandezët, Hungarezët, Polonezët, Finlandezët, Serbët: këta ishin popujt kryesorë pakë a shumë të shtypun për fatin e te cilvet interesoheshe Nderkombëtarja e Dytë. Për sa i perketë qinda miljonave azjatikë, afrikanë, të ndryedhun nën zgjedhen ma brutale po thuejse askush nuk interesohej. Dukësh e pa mundun me vuem në të njajten rradhë te bardhët dhe te zezët, te „qytetnuemit" dhe te „egrit". Veprimi i Nderkombëtares së Dytë në favor te kolonive kufizohesh në disa vendime të rralla dhe te pa çanësueshme në te cilat çeshtja e çlirimit te kolonive mshefej me kujdes.

Ky oportunizëm në çashtjen kombëtare ka jetue mjaftë, Leninizmi e ka zbulue këtë; Ai e ka çkatrue murin midis të barrdhëve e te zezve. europjanë dhe eksotikë, i ka asimilue skllavat e „qytetnuem" më skllavët e „jo qytetnuem" t'imperijalizmit dhe ka lidhë në këtë mënyrë çeshtjen kombëtare me çeshtjen kolonjale. Kështu çeshtja kombëtare asht ba nji çeshtje nderkombëtare: ajo e çlirimit te popujve të shtypun te kolonive dhe të vendeve te nenshtruem̈e nga inperijalizmi.

Ma përpara, e drejta e kombëve me disponue me vehten e tyne ishte shpesh herë e zbritun në te drejten e autonomis. Disa leader të nderkombëtares së dytë shtyheshin gjersa me e sherdrue këte në te drejten e autonomis kulturale; me fjalë tjera, ata i njifshin kombeve te shtypuna te drejten me pasë institucjonet e tyne kulturale, porse u ndrojshin të drejten m'u çlirue nga zgjedha politike e kombit zotnonjes. Kështu që, e drejta e kombeve për të disponue me vehten e tyne, rrezikonte me shërbye për të perligjë aneksimet. Këjo ngatrresë tash ma asht zhdukë. Leninizmi e ka zgjanue kuptimin e së drejtës të popujve me disponuem me vehten ë tyne; ai u ka njoftë kolonive dhe vendeve të nënshrueme te drejtën m'u shëkputë krejtësisht nga Shteti për te cilin janë të lidhun, dhe me përbamë Shtete të pamvaruna. Me këte mënyrë asht largue edhe mundësija me përligjë aneksimet. Kështu, parimi i së drejtës të popujve me disponue me vehten e tyne i cili, gjatë luftave imperijaliste, ka qenë në duert e socjal-patriotëve nji vegel për te gënjye turmat, shërben tani për të demaskue rrymët imperijaliste dhe manovrat shoviniste, dhe

përfaqeson një vegël për edukimin politik të turmave në frymën e internacjonalizmit.

Përpara, çështja e Kombeve të shtypuna shikohej zakonisht si një çeshtje juridike; Çpallja madhështore e barazisë të qytetarëve te një vendit, çpalljet e pa-numrueshme mbi barazinë e Kombeve qe më çka gzilìroheshin (talleshin) partitë e Nderkombetares së II-të, duke mshefë me kujdes faktin se nën imperijalizmin, i cili i lejon disa popujve me jetue me çfrûtëzimin e te tjerëve, „barasija e Kombeve“ nuk asht tjetër veçse një pjellë e mendjes. Leninizmi e ka demaskue hypokrizinë e kësaj pikë-pamjeje juridike mbi çeshtjen Kombetare. Ai ka tregue se, pa një mbeshtetje direkte të partive proletare ne luften e popujve te shtypun, deklaratat madhështore mbi barasinë e Kombeve nuk janë veçse fraza gënjeshtare. Në këte mënyrë, çeshtja e kombeve te shtypun asht bamë çeshtja e përkrahjes së vazhdueshme te popujve te shtypun në luften e tyne kundër imperijalizmit për pamvarësinë e tynë kombëtare.

Për reformizimin, çështja Kombëtare ishte një çështje e pamvarun, e pa-lidhun me çështjen e zotnimit të kapitalit, me përmbysjen e imperializmit, me revolucjonin proletar. Në heshtje pranohesh se ngadhnjimi i proletarjarit n'Europë ishte i mundëshëm pa një aleancë direkte me lëvizjen e çlirimit Kombëtar te kolonive, se zgiidhja e çështjes kolonjale mund te gjendet jashta revolucjonit proletar, jashta luftës kundër imperjalizmit. Këjo pikëpamje kundër revolucjonare asht demaskue tashma. Leninizmi ka sprovue se lufta imperialiste dhe revolucjoni në Rusi kanë vërtetue se çështja kombëtare

nuk mundë te zgjidhet veçse mbi sheshin e revolucjonit proletar, se ngadhnjimi i revolucjonit në perëndim nevojitë lidhjen e proletariatit eurojan me lëvizjen e kolonive dhe të vendeve të nënshtruem kunder imperjalizmit. Çeshtja kombëtare asht pjese e çeshtjes së përgjithëshme të revolucjonit proletar, pjesë e çeshtjes së diktaturës së proletariatit.

Në lëvizjen për pa-mvarësinë kombëtare të vëndeve të shtypuna a gjindet mundësi revolucjonare, dhe në qoftë se po a mundë të për o en për revolucjorin proletar, për të shëndrruem vëndet kolonjale dhe të shtypura, nga rezerva të borgjezisë imperialiste, n' aleat të proletarjatit revolucjonar? Kështu na paraqitet sot çështja. Leninizmi përgjegjet pohimisht; me fjalë tjera ai njeh qenjen e këtyne mundesive revolucjonare dhe e gjykon të nevojëshme për t'i përdorë për përmbysjen e armikut të përbashkët, imperjalizmit. Mekanizmi i zhvillimit të imperializmit, lufta imperialiste dhe revolucjoni rus vërtetojnë krejtësisht deduksjonet e Leninizmit mbi këtë çështje.

Prej këndej rjedh nevoja, për proletarjatin, me e ndihmue aktivisht dhe ve dimtarisht lëvizjen çlirimtare të popujve të shtypun.

Sigurisht kjo nuk don të thotë se proletarjati duhet të ndihmoj *çfarëdo lëvizje kombëtare*. Ai duhet të ndihmoj ato që sjellin ligështimin, përmbysjen e imperjalizmit dhe jo mbajtje dhe fuqizimin e tij. Ndodhë që lëvizjet kombëtare të disa vendeve të shtypuna janë në kundërshtim me interesat e lëvizjes proletare. *Në këtë rast nuk duhen, përkrahë aspak*. Çeshtja e të drejtave të nji kombit nuk asht nji çështje e izolueme e pa-mvarun,

por pjesë e çështjes së përgjithësh me të revolucjonit p o-letar. Prandej ajo duhet t'i përshtatet, t'i nënshtrohet kësaj të fundit. Në vi in 1850, Marx i ishte për lëvizjen kombëtare të polonezëve dhe të ungarezëve dhe kundra asaj të çekëve e të sllavëve të jugut. Perse? Sepse atëherë këta të fundit ishin „popuj reaksjonarë", avampostët e Rusisë autokratike në Europë, kurse Polonezët dhe Hungarezët ishin „popuj revolucjonarë" që lufto shin kundër autokracisë. Sepse me ndihmue lëvizjen kombëtare të çekëve e të sllavëve të jugut donte me thanë me ndihmue tërthorazi carizmin, anmikun ma të rrezikshëm të lëvizjes revolucjonare n' Europë.

Kërkesat e ndryshme të demokracisë, dhe midis të tjerash e drejta e popujve me disponue me vehten e tyne, nuk janë nji gja absolute, porse nji pjesë e lëvizjes demokratike (Socjaliste) botnore. Mundet që në disa rasë pjesa të jetë në kundërshtim me tanësinë e atëherë duhet me e hedhë këtë pjesë (Lenini: Bilani i bisetimit).

Kështu pra, disa lëvizje kombëtare, të kqyruna nga pikpamja reale dhe interesave të lëvizjes revolucionare e jo nga pikëpamja formale e së drejtës së thatë (abstrakte), mund rë kenë nji karakter reaksionar (kundërshtimi).

Po ashtu, karakteri i pa dyshimtë revolucjonar i ma të shumtave lëvizje kombëtare asht po aq i dyshimtë dhe i veçantë, sa edhe kundërshtimi (reaksjonizmi) i disa lëvizjeve të tjera. Për me qenë revolucjonare, nji lëvizje kombëtare nuk asht e domosdoshme të formohet prej elementash proletarë, të ketë nji program revolucjonar

ose republikan, nji bazë demokratike. Lufta e Emirit të Afganistanit për pamvarësin e vendit të tij asht objektivisht nji luftë revolucionare me gjithë që Emiri dhe zavendësit e tij ishin monarkista, sepse ajo dobësonte, ndanë, përmbysë imperjalizëm, kurse lufta e demokratëve e „socialistëve" e „revolucionarëve" dhe e republikanëve si Keresky e Tseretelli, Renaudel e Scheneidemann, Tcherna e Dan, Henderson e Clyner, lufta e këtyne pra gjatë luftës imperjaliste ishte nji luftë *reaksjonare*, se ajo kishte si përfundim me e lyë përsipër imperjalizmin, me e përforcue dhe me e sjellë në fitore. Po kështu lufta e tregtarëve dhe intelektualëve borgjezë egjyptjanë për pamvarësin e Egjyptit, asht nji luftë objektivisht revolucionare, me gjithë origjinën dhe konditat borgjeze te prijsëve të lëvizjes Kombëtare, me gjithë kundërshtimin e tyne me socializmin; kurse lufta e qeverisë puntore Angleze për mbajtjen e Egjyptit nden mbikqyrjen e Britanisë së madhe, asht nji luftë reaksionare, me gjithë origjinën e konditat proletare të pjestarëve të kësaj qeverije, me gjithë që ata thojshin se janë të bindun në socializëm. Po kështu lëvizja Kombëtare e shteteve të mëdhej kolonjalë e të skllavëruem të Hindit e të Kinës, sa do që i kundërshton principet e demokratis formale, asht prap se prap nji grusht i drejt për drejt kundër imperializmit e pra nji lëvizje revolucionare.

Lenini ka arësye kur thotë se duhet me e shikue lëvizjen Kombëtare të popujve të shtypun jo në pikëpamje të demokracis formale, por në pikëpamje të përfundimeve që ajo ka mbërritun në luftën e përgjithëshme kundër imperjalizmit, me fjalë të tjera duhet me çmue

këtë lëvizjë „jo të ndarë", por si një pjesë e lëvizjeve të mbarë botës.

Levizja çliruese e popujve te shtypun dhe revolucioni proletar

Per zgjidhjen e çeshtjes kombëtare leninizmi nisët nga këto mendime:

1) Bota asht ndamë në sheshe: në një anë një numër fare i vogel kombesh të qytetnuem që kanë po thuej gjithë kapetalin financiar dhe eksploatojnë pjesen tjeter popujt e shtypun dhe t'eksploatuem të kolonive dhe të vendeve të skllavnuem, që formojnë shumicën e popullatës.

2) Kolonitë dhe vendet e skllavnueme e t' eksploatueme prej kapetalit financiar formojnë një rezervë forcash shumë të madhe për imperjalizmin.

3) Vetem me anë të lujtës revolucionare kunder imperjalizmit popujt e shtypun të vendeve kolonjale dhe të skllavnueme do të mbërrijnë me u çliruem prej zgjedhes dhe eksploatimit.

4) Popujt kryesor te skllavnuem kanë hymë tashma në udhën e lëvizjeve çlirimtare kombëtare që duhet të sjelli me doemos krizen e kapetalizmit botnorë.

5) Interesat e lëvizjes proletare ne vendet e perparueme dhe të lëvizjes kombëtare në kolonit, kerkojnë që kto dy lëvizje revolucionare të bajnë një front të vetëm kundra armikut të përbashkët imperjalizmit.

6) Fitorja e klases puntore në vendet e përparueme dhe çlirimi i popujve të shtypun nga imperijalizmi

janë të pamundshme pa formimin dhe pa përforcimin e e nji fronti revolucionar të përbashkët.

7) Formimi i nji fronti revolucionar të përbashkët nuk asht i mundun veçse në qoftë se proletariati i vendeve shtypës njihmon drejt per së drejti dhe me bindje lëvizjen e pamvarsis kombëtare të popujve të shtypun kundër imperializmit të metropolit, sepse „nji popull që shtyp të tjerët nuk mund të jetë vetë i lirë" *(Lenin)*.

8) Kjo ndihmë qëndron në përbotësimin dhe zbatimin e principit të së drejtes së kombeve me u ndamë nga metropoli e me ndërtuem shtete të pamvaruna.

9) Pa zbatimin e këtij principi asht e pamundun me realizue bashkimin e kombeve në nji ekonomi të përbotëshme e të vetme, baza materiale e fitores socialiste.

10) Ky bashkim nuk mundet me qenë veçse me dashje (me vullnet) dhe i bazuem në besimin ndaj shoshoqrin dhe ljihjet vllaznore të popujve të ndryshëm.

Prej këtyne dalin dy prirje (tendenca) në çashtjen kombëtare: prirja për çlirimin politik nga zgjedha e imperializmit dhe per formimin e Shteteve nacionale të pamvarun, prirje kjo që e ka burimin e sajë në reaksionin kundër shtypjes imperialiste dhe ëksploatimit kolonial, edhe prirja për afrimin ekonomik të kombeve, prirje e përcaktueme nga formimi i nji tregu botnor dhe i nji ekonomije botnore.

„Historija e kapitalizmit na kallzon dy prirje në çashtjen kombëtare: E para asht zgjimi i jetës kombëtare dhe i lëvizjeve kombëtare, lufta kundër çdo shtypje kombëtare, krijimi i shteteve nacionalë. E dyta asht zhvillimi i marrëdhanjeve të çdo lloj midis kombeve, shkat-

rrimi i pengesave kombëtare, krijimi i nji njisije ndërkombëtare të kapitalit, i njisis ekonomike, polittke, shkencore, etj. Kto dy prirje janë ligja botnore e kapitalizmit. E para sundon në fillim të zhvillimit te tij; e dyta karakterizon pjekuninë e kapjtalizmit që ecën drejt transformimit në shoqni socialiste" (*Lenin; Shënime kritike*).

Për imperializmin kto dy prirje janë kundërshtime të pa thyeshme, sepse ai nuk mund të rrojë pa eksploatim kolonistë, pa i përmbajtun me anë të forcës në rrethin e nji „njisije të vetme"; ai nuk mund t'i afrojë kombet veçse me anë të pushtimeve dhe të përhapjes koloniale, pa të cilat nuk mund të kuptohet qenja e vetë imperializmit.

Përkundrazi për komunizmin kto dy prirje nuk janë veçse dy faza të nji zhvillimi të vetëm: çlirimi i popujve të shtypun nga zgjedha e imperializmit. Në të vërtetën na e dijmë që shkrimja ekonomike e përbotëshme nuk asht e mundun veçse tue u mbështetë në besimin ndaj sho-shoqin dhe simbas nji lidhje të pranueme lirisht; na e dijmë se formimi i nji bashkimi me dashje të popujve duhet të vije mbas ndamjes së kolonive nga „tanësija" imperialiste „e vetme", mbas ndërrimit të ktyne kolonive në shtete të pa-mvarun.

Pra nga kjo kuptohet nevoja e nji lufte pa pushim e të ashpër kundër shovinizmit (dashuni e teprueme për atëdhe) të „socialistave" të fuqive të mëdha (Angli, Francë, Amerikë, Itali, Japoni etj.) që nuk duen me i luftue qeverit e tyne imperialiste dhe me përkrahë luftën e kolonive të shtypuna per çlirimin e tyne, për ndamjen e tyne prej metropolit (atdheut pushtues).

Pa këtë luftë asht e pamundun me e edukuem klasën puntore të kombeve sunduese në shpirtin e internacionalizmit të vërtetë, me afrue atë me turmat puntore te kolonive dhe të vendeve të skllavënuem, me e pregatitë per revolucionin proletar. Revolucioni nuk do të kishte triumfuem në Rusi, Koltchaku dhe Denikini nuk do t'ishin mundë, në qoftë se proletariati rus nuk kishte per vehte simpatin dhe ndihmën e popujve të shtypun prej imperatoris së vjetër cariste. Por për me pasë simpatinë dhe ndihmën e tyne, proletarjati rus kputi së pari zinxhirët e tyne dhe i çli oi nga zgjedha e imperializmit rus. Pa këte do të kishte qenë e pamundun me e vue në baza të forta qeverin sovjetike, me ngulë internacionalizmin e vërtetë dhe me krijuë këte organizim të math bashkepunimi midis popujve që quhet Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike dhe që paraqet shembëllin e parë të bashkimit t'ardnshem të popujve në nji ekonomi botnore të vetme.

Pra kuptohet nevoja me luftue në vëndet e shtypun shpirtin e ngushtë të socialistave që nuk shofin veçse interesat e tyne kombetare të drejt për drejta, kufizohen në veprimin e tyne lokal dhe nuk duen te dijnë nga lidhja e levizjes çlirimtare të vëndit tyne me lëvizjen proletare të vëndeve shtypës.

Pa këte asht e pamundun me e përmbajtë solidaritetin e klasës së proletariatit të kombeve të shtypun me atë të vëndeve sunduese, në luftën e tyne kundër anmikut të përbashkët imperializmit; pa këte asht e pa mundun me realizue internacionalizmën.

Kjo asht udha që duhet ndjekë për edukimin e turmave puntore të kombeve të shtypun dhe të kombeve sunduese në drejtim të internacionalizmit revolucionar.

Ja se ç'thotë Lenin për këtë edukatë: Kjo edukatë a mundet me qenë po ajo si në kombet e mëdhej që shtypin të tjerë ashtu dhe në kombet e vegjël e të shtypun, si në vëndet që pushtojnë ashtu dhe në vëndet që janë pushtuem?

Sigurisht jo. Ecja drejt qëllimit të vetëm që asht njësija e plotë, afrimi i ngushtë, shkrimja e të gjithë kombeve, mund të ndjeki udhë të ndryshme. Kështu, për me mbërri në nji pikë që gjindet në mesë të nji faqje, mund të nisemi si nga ana e majtë, ashtu dhe nga e djathta e kësaj faqje. Në qoftë se nji socialist i nji shteti të math shtypës, tue predikuem shkrimjen e popujve harron se Nikolla i II-të, Wilhelm, Gjergji i V-të, Poincare dhe të tjerë janë edhe ata të mendimit për nji „shkrimje" me kombet e vegjël (me anë të pushtimit), harron edhe se Nikolla i II-të asht i mendimit për „shkrimjen" me Belgjiken, etj; ai socialist në teori ruk do të jetë veçse nji predikues qesharak dhe në praktikë nji ndihmës i imperializmit.

Pika e randimit t'edukatës internacionaliste të punëtorëve në vendet shtypës, duhet të qëndrojë në propagandën dhe në përkrahjen me punë të së drejtës së popujve të shtypun me u ndamë nga metropoli. Na mu nemi dhe duhet që të quejmë si të poshtër e imperialist, çdo socialist, të nji shteti shtypës, në qoftë se nuk ban këtë propagandë. E drejta e ndamjes nga metropoli asht nji kërkesë e doemosdoshme, sadoqë deri me ardh-

jen e socializmit kjo ndamje nuk mund të bahet veçse ndonji për mijë.

Përkundrazi socialisti i nji vendi të vogël duhet ta drejtojë pikën e randimit të lëvizjes së tij në pjesën e dytë të formulës s'onë: „bashkim me dashje" i kombeve. Sa i shkelen detyrat e tijë si internacionalist ai mund të jetë edhe për pamvarësinë politike të vendit të tij, edhe për bashkimin ë tij me nji çfardo shtet fqinjë. Por si do që të jet si duhet të luftoi kundar ngushtësis së ndjenjave kombëtare, të mos kufizohet në lëvizjen e tijë, t'a shikojë përgjithësinë e lëvizjes, të kuptojë së duhet me e lanë me nji anë interesin e veçantë perpara interesit të pergjithëshëm.

Ata që nuk e kanë thellue mirë çashtjen, shofin nji „kundershtim" në punën se si socialistat e vendeve shtypës duhet të kërkojnë „lirin e ndamjes" dhe socialistat e vendeve të shtypuna „lirin e bashkimit" me nji popull tjeter. Por mjafton pak gjykim per me pamë se nuk ka udhë tjetër drejt internacionalizimit dhe shkrimjes së popujve, veç asaj që po kallzojme në thezën t'onë (Lenini në: Bilani i bisedimeve).

Tri periudhat e zhvillimit historik te çashtjes kombëtare

...Pa tjetër duhet të vërtetohen disa fakte paraprake, pa të cilët zgjidhja e çeshtjes kombëtare asht e pa mundëshme. Këto fakte paraprake kanë të bajnë: me çashtjen e çfaqjes së kombeve, lindjes se shtypjes kombëtare, formës së shtypjes kombëtare në procesin e zhvillimit historik dhe, ma në fund me format e zgjidhjes së çashtjes kombëtare në periudhat e ndryshme të zhvillimit.

Kemi tri kësi periudhash.

Periudha e pare esht periudha e likuidimit të feudalizmit dhe e fitores se kapitalizmit në perendim. Bashkimi i njerzve në komb ngjet në këtë periudhë...

...Periudha e parë karekterizohet me çfaqjen e kombeve n'agimin e parë të kapitalizmit, kur në perendim t'Europës lindin shtete thjesht kombëtare, pa shtypje kombëtare, dhe në lindje, shtete shumë kombesh, me nji komb ma të zhvilluem në krye dhe me kombe tjerë ma pak të zhvilluem, qe ndodhen nën mvarsinë politike e ekonomike te kombit sundues. Këto shtete shumë kombesh të lindjes, kanë sherbye si atcheu i asej shtypjeje kombëtare, që ka kriju konfliktet kombëtare, lëvizjet kombëtare, çashtjen kombëtare dhe mënyrët e ndryshme të zgjidhjes së kësaj çashtje.

Periudha e dytë në zhvillimin e shtypjes kombëtare dhe mënyrën e luftës kundra kësaj, përkon me periudhën e fqajes s'imperjalizmit, kur kapitalizmi-në kërkim të tregjeve, landëve të para, landëve djegëse dhe fuqis puntore të lirë, kur ai, në luftën për eksportimin e kapitalit dhe sigurimin e rrugëve të mëdhaja hekur-udhore e detare,-del nga kuadri i shtetit kombëtarë dhe e zgjanon territorin e vet në kurriz të fqijve, të afërmë e të largët. Në këtë periudhe të dytë, shtetet e vjetra kombëtare të perëndimit: Anglija Italija, Frarca pushojnë së qenuni si shtete kombëtare, d, m. th. se ato, me forcë, rrëmbejnë territoret e tjera dhe shëndrrohen në shtete shume kombesh, kolonjale, gja me të cilën çfaqet shtypja kombëtare e kolonjale, e cila dikur ekzistonte vetëm në lindje t'Europës. N Europën lindore kjo periudhë karakterizohet: me zgjimin dhe forcimin e kombeve të shtypune (Çekt, Polonezët, Ukrainët) dhe, si pasoje e luftave imperjaliste, me shkatrrimin e shteteve të vjetër borgjezë shumë kombesh dhe formimin e shteteve të ri kombëtarë, që ndodheshin nën robnin e të ashtu quejtunve shtete të mëdhaj.

Periudha e tretë asht periudha Sovjetike, periudha e shkatrrimit të kapitalizmit dhe likuidimit të shtypjes kombetare, ku çashtja e kombeve zotnuesë dhe të shtypunë, e kolonive dhe e metropoleve, hidhet n'arkivën e historis, kur, para nesh, në territorin e Republikave Socialiste Federative Sovjetike të Rusis jetojnë kombe me të drejta të barebarta, mundësi të barabart zhvillimi, por që ruejnë nji far trashigimi historik mos barazije në pikpamje të mbrapambetjes së tyne ekonomike, politike e

kulturale. Substanca e kësaj mos barazije të kombeve, qendron këtu: sepse nëpër mes të zhvillimit historik-na kanë mbet trashigime nga e kaluemja për shkak të të cilve nji komb, b. f. ai i Rusëve të Mëdhaj, në pikpamje politike dhe industriale çfaqet ma i zhvilluem se sa kombet tjerë. Prej këndej rrjedhë ajo mos barazi „defakto", e cila nuk mund të çduket për nji vjet. Me gjithë këtë, tue ju dhanë kombeve të mbrapambetuna ndihmën ekonomiko-politike e kulturale, çdukja e sajë mund të mbrihet.

Qe pra, këto janë tri periudha te zhvillimit të çashtjes kombëtare që kanë kalue historikisht para syve t'onë.

Dy periudhat e para kanë nji karakteristikë të përbashkët: Në të dy perjudhat, kombet pësojnë shtypjen dhe robnin, prandaj lufta kombëtare vazhdon gjithnji dhe çashtja kombëtare mbetet e pa zgjidhun. Por në mes të këtyne dy periudhave ka edhe ndryshim. Ndryshimi qëndron këtu: Në periudhën e parë çashtja kombëtare nuk del nga kuadri i shteteve të veçantë shumë kombesh dhe përfshinë vetëm nji numër të vogël kombesh, kryesisht europjane, ndërsa në periudhën e dytë, çashtja kombëtare shndrrohet nga nji çashtje e mbrendëshme shteti në çashtje që shtrohet në mes të shteteve te ndryshëm, në çashtje të luftës në mes të shteteve imperjalistë për mbajtjen e kombeve në gjendjen e mvarësis e të mos barazis në të drejta, për futjen e kombeve dhe të fiseve të tjera jashta Europe nën influencën e vet. Kësi soji, çashtja kombëtare e cila dikur kishte randësi vetëm për vendet e kulturueme, në këtë periudhë e humbë karakterin e sajë të veçantë dhe shndrrohet në çashtjen e përgjithshme të kolonive.

Zhvillimi i çashtjes kombëtare në çashtje të përgjithshme kolonjale, nuk asht kurfarë rastësije historike. Ky zhvillim, në rend të parë, shpjegohet me këtë: në kohën e luftës imperjaliste, vet grupet imperjaliste të shteteve ndërluftuesë, janë të shtrënguemë me u bamë thirrje kolonive të veta, prej kah nxjerrin materjalin njerzuer me të cilin formojnë armatat e tyne. Pa dyshim ky proces-proçesi i thirrjes së pa evitueshme të imperjalistave kombeve të mbrapambëtuna kolonjale-nuk kishte se si të mos i zgjonte këto fise dhe kombe në luftën për çlirimin e tyne. Pastaj, faktori i dytë, që ka sjellë si përfundim zgjanimin dhe zhvillimin e çashtjes kombëtare në çashtje te përgjithshme kolonjale, e cila ka përfshi në fillim me shkëndina e pastaj edhe me flakën e levizjes çlirimtare te tanë lamshin toksuer, asht përpjekja e grupeve imperjalistë për coptimin e Turkisë dhe çrrukjen e ekzistencës së saj kombëtare. Turkija, si shteti ma i zhvilluem në mes vendeve të popujve Mysliman, nji Turki kësi soji nuk mund të pajtohesh me këtë përspektivë, prandej ngriti bajrakun e luftës dhe mbështuell rreth vedit popujt e Lindjes kundra imperjalizmit. Faktori i tretë asht çfaqja e Rusis Sovjetike, lufta e së cilës kundra imperjalizmit botnuer ka pasë nji seri suksesesh dhe pa tjeter ka frymzue popujt e shtypun të Lindjes, i ka zgjue, i ka ngritë në luftë dhe kësi soji ka krijue mundësin e formimit të frontit të përgjithshëm të kombeve të shtypunë, ç'prej Irlande deri në Hindi.

Që, këta janë te tre faktorët që, në fazen e dytë të zhvillimit të shtypjes kombëtare, shpjegojne sepse shoqnija borgjeze jo vetem s'ka mujtë të zgjidhte çashtjen

kombëtare, jo vetem nuk ka sjellë paqen në mes të popujve, por perkundrazi shkedin e luftes kombëtare e kakthye në flaken e luftes së popujve të shtypun, të kololonive dhe të gjymës - kolonive, kundra imperijalizmit botnuer. Shifet kjartazi se reqjimi i pushtetit Sovjet k, regjimi i diktaturës së proletarjatit, u tregue si i vetmi regjim i aftë me zgjidhë çështjen kombëtare, d.m.th. si regjim i aftë me krijue kushtet që sigurojnë ndertimin paqsuer dhe bashkimin vllaznuer të kombeve e fiseve te ndryshem.

S'asht nevoja të tregoimë se nen pushtetin e kapitalit, të pronësis private mbi mjetet e prodhimit e per deri sa të ekzistojnë klasët, nuk asht e mundun të sigurohet barazija e kombeve, se per deri sa t'ekzistojë fuqija e kapitalit, per deri sa të bahet lufta per zaptimin e mjeteve të prodhimit, nuk mund të ketë kurrfar barazije në mes të kombeve, sikurse nuk mund të ketë as bashkpunim ne mes të turmave punonjse të kombeve. Historija na verteton se mënyra e vetmë per shkatrimin e mos barazis kombëtare, menyra e vetme e vendosjes se regjimit të bashkpunimit vellaznuer te turmave punojse të popujve te shtypun e io të shtypin asht—likuidimi i kapitalizmit dhe vendosja e sistemit sovjetik.

Perveç kësaj historia tregen se edhe po qe se disa popuj kanë me mujtë me u çlirue nga borgjezija e tyne kombëtare si edhe nga borgjezija e „huej" d. m. th. të kenë vendosë nder vendet e tyne sistemin Sovjetik, ata nuk janë në gjendje-n'epoken e imperjalizmit-me qendrue veç e veç dhe me mbrojtë me sukses ekzistencën e e tyne pa përkrahjen ekonomike e ushtarake nga ana e

republikave fqinjë. Sembulli i Maxharrisë na vërteton naptazi se pa shtetin e Bashkimit të Republikave Sovjetike, pa Bashkimin e tyne në nji forcë të vetme ushtarake ekonomike, nuk mund t'u bahet ballë forcave të bashkueme t'imperjalizmit botnuer, as nder frontet ushtarake as në ato ekonomike.

(STALIN, Marksizmi dhe çashtja kombëtare-kolonjale, detyrët që i shtrohen Partisë në rend të ditës në çashtjen kombëtare, 1921)

B.R.S.S. si formë shtetnore bashkpunimit te popujve

Kur u formuen Republikat Sovjetike, të gjit shtetet e botës u ndanë në dy bloqe: në bllokun e ka talizmit e në atë te Socializmit.

Andej, në bllokun e kapitalizmit urrejtja e m barazija kombëtare, skllavnija kolonjale e shoverizi shtypja kombëtare e masakrimevet, barbarsija imperjali dhe luftat.

Këndej, në bllokun e Socializmit-besimi recipr e paqe, lirija e barazija kombëtare, jeta e përbash paqsore dhe bashkpunimi vllaznuer i popujve.

Përpjekjet e botes kapitaliste, vjetë me radhë, t'a zgjidhë çashtjen kombëtare me methodhër e harr nizmit të zhvillimit të lirë të popullit me sistemin çfrytzimit të njerut pre njerjut, u treguen të pa-suks Perkundrazi lamshi i kontradikitave kombëtare gjithnji i tepër ngatrrohej, tue krenue vet ekzistencen e kapitalizm Borgjezija u tregue e pa fuqishme me realizue bash min e popujve.

Vetëm në bllokun e Sovjetëve, vetëm në kush e diktaturës së proletarjatit, që ka mbështjellë rreth veh shumicën e popullsis, u tregue i mundëshëm shkatrri rranjësuer i shtypjes kombëtare, krijimi i gjëndjes së

simit reciprok dhe vendosja e themeleve të bashkpunimit vllaznuer të popujve.

Vetëm në sajë të këtyne rrethanave, Bashkimi Sovjetik ka mujtë me zbrapë sulmet e imperjalistave të mbarë botës, të mbrendëshëm e të jashtëm; vetëm në sajë të këtyne rrethanave, Republikat Sovjetike, kanë mujtë me likuidue me sukses luftën qytetare, me sigurue ekzistencën e tyne dhe me ia hye ndertimit paqsuer ekonomik.

Por vjetet e luftës nuk kaluen pa pasojë. Fushat e shkretnueme, fabrikat e mbrapambetuna, fuqitë prodhuese të rrënueme dhe burimet ekonomike të shtjerruna - që lufta ka lanë si trashigim mbas veti, - shkaktojnë që, në ndërtimin ekonomik fuqinat e veçanta të Republikave, veç e veç, të jenë të pa mjaftueshme. Tue qendrue Republikat të veçueme, u tregue i pa mundëshëm ristabilizimi i ekonomisë së popullit.

Nga ana tjetër, paqëndrueshmënija e pozitës nderkombëtare dhe rreziku nga sulmet e ban të domosdoshëm ndërtimin e frontit të vetëm të Republikave Sovjetike faqe rrethimit kapitalist.

Ma në fund, vetëm ndërtimi i Buxhetit Sovjetik Internacional për natyrën e vet të klasës, i shtjen turmat punojse të Republikave Sovjetike në rrugën e bashkimit në nji familje Socjaliste.

Të gjitha këto rrethana kërkojnë kategorikisht bashkimin e Republikave Sovjetike në nji Shtet Federativ, të aftë me sigurue integritetin e jashtëm dhe ngritjen ekonomike të mbrëndëshme e zhvillimin e lirë kombëtarë të popujve.

Lirija e popujve të Republikave Sovjetike që ka disa kohë janë mbledhë në kongresin e Sovjetëve të tyne dhe nji zani kanë aprovue vendimin mbi formimin e „Bashkimit të Republikave Socjaliste Sovjetike" asht nji provë se ky Bashkim asht rezultat i Bashkimit të vullnetshëm të popujve me të drejta të barabarta, ku ç'do Republike i asht sigurue e drejta e daljes së lirë nga Bashkimi; se hyemja në Bashkim asht e haptë për të gjitha Republikat Socjaliste Sovjetike, si për ato që ekzistojnë si edhe për ato që do të lindin në të ardhëshëm; se shteti i ri federativ asht kunorëzimi i dënjë i themelimit të jetës së përbashkët paqsore dhe bashkpunimit vllaznuer të popojve, themeleve që janë vue qysh në Tetuer 1917 dhe se shteti federativ do të sëbrbejë si mbrojtje e sigurtë nga kapitalizmi botnuer dhe si hap i ri vendimtar në rrugën e bashkimit të puntorve të të gjitha vendeve me Republikën Socjaliste Sovjetike Botnore.

Tue i shpallë të gjitha këto para të gjithë botës dhe tue proklamue integritetin e themeleve të pushtetit Sovjetik, që kanë gjetë shprehjen e tyne ndër konstitutat e Republikave Socjaliste Sovjetike, të cilat na kanë dhanë fuqi të plota, na, deputetët e këtyne republikave, në bazë të fuqive të plota të dhanuna, vendosim nënshkrimin e paktit mbi krijimin e „Bashkimit të Republikave Socjaliste Sovjetike".

(STALIN, Marksizmi e çashtja kombëtare-kolonjale, 1925.

Marrëdhanjet ne mes te kombeve te B.R.S.S.

Nuk do t'ishte e plotë pasqyra e ndryshimeve në jeten shoqnore të BRSS, po të mos i thojshim disa fjalë per ndryshimet edhe në nji fushë. Mendoj per fushen e marrëdhanjeve në mes kombeve të BRSS. Siç asht e dijtun, në Bashkimin Sovjetik gjinden afer 60 kombe, grupe kombëtare dhe kombësina. Shteti sovjetik asht shtet prej shum kombesh. Kuptohet vetvetiu se çeshtja e marrëdhanjeve reciproke në mes popujve të BSRS për nè duhet të ketë pa-tjeter randësi të dores së parë.

Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike asht krijue, siç dihet, në vitin 1922, në Kongresin e Parë të Sovjetit të BRRS. Asht krijue në baza të parimeve të barazis dhe vullnetit të lirë të popujve të BRSS. Statuti q'asht tash në fuqi e q'u pranue ne vitin 1924 asht Stattuti i parë i Bashkimit të BRSS. Ajo ka qenë periudha kur marrëdhanjet në mes popujve akoma nuk ishin rregullue si duhet, kur mbeturinat e mos-besimit kundrejt Velikorusve nuk kanë qenë zhdukë akoma. Kur forcat centrifugale vazhdojshin gjithnji me veprue. Ishte e nevojshme të rregullohet bashkpunimi vllaznor në mes popujve në këto kushte në bazë të ndihmes reciproke ekonomike, politike e ushtarake, tuë i bashkue në nj

shtet aleat shum kombesh. Pushteti sovjetik pa-tjeter duhet t'i shifte veshtirsinat e kesaj vepre, Ai ka pasë para vedit tentativat pa-sukses të shteteve shum kombesh ne vendet borgjeze. Ai ka pasë para vedit eksperimentin e deshtuem t'Austro-Hungaris. Por, me gjithë këtë, ai bani tentativen e formimit të shtetit shum kombesh, sepse e ka dijtë se shteti shum kombesh, i lidun në bazë të socializimit, duhet t'u bajë, ball provave të ndryshme.

Qe prej atëherë kanë kalue 14 vjetë. Periudhë mjaftë e gjatë sa të kontrollohet (provohet) tentativa. Dhe ç'ngjau? Periudha e kalueme pa-dyshim ka tregu se tentativa me krijue nji shtet shum kombesh, të krijuem në bazë të socializimit, ka pasë sukses të plotë. Këjo asht fitore e padyshimte e politikes kombëtare lenjiniste.

Si t'a spjegojmë këtë fitore?

Mungesa e klasave shfrytzuese, të cilat janë organizuesat kryesore të grindjeve në mes të kombeve: mungesa e shfrytzimit, i cili zhvillon mosbesimin reciprok dhe ndez dëshirat nacionaliste; qenja në pushtet e klases puntore; e cila asht anmike e çdo skllavnimi dhe flamurtare besnike e idenave t'internacionalizmes; realizimi i provuem i ndihmes reciproke të popujve në të gjitha fushat e jetes ekonomike e shoqnore; së fundi lulzimi i kultures nacionale të popujve të BRSS, nacionale per kah forma, socialiste perkah permbajtja, — të gjithë këta faktorë dhe tjerë kësi soji kanë shkaktue që asht ndryshue fizionomija e popujve të BRSS që nga themeli, që asht zhduk tek ata ndjenja e mosbesimit nder veti, që asht zhvillue tek ata ndjenja e miqsis reciproke dhe në këtë mënyrë asht krijue bashkpunimi i vertet vllaznor i popujve në

sistemin e shtetit të vetë, të perbashket (aleat) unik.

Tash kemi si rezultat shtetin socialist të shum kombesh, plotësisht të formuem, që i ka perballue të gjitha sprovimet, dhe forcen e tij, mund t'a lakmojë cili do shtet kombëtar në çdo pjesë të botes.

Këto janë ndryshimet që janë krye në periudhen e kalueme në fushen e marrëdhanjeve në mes kombeve të BRSS.

Këto janë ndryshimet që kanë nodhë në periudhen e kalueme të jetes ekonomike dhe shoqnore-politike të BRSS, që kane marrë fuund në periudhen që nga viti 1924 deri në 1936.

Lenjin

Krenarija kombëtare

Në fillim të luftes së parë botnore me 12 Dhetuer të vitit 1914, Lenjini publikoi në fletoren „Social-demokrati" artikullin: Krenarija kombetare e Velikorusëve (Rusve të Rusisë së Madhe) prej të cilit po botojmë pjesen ma me randësi.

Sa flitet tash, diskutohet dhe bërtitet per kombësi, per Atdheun! Ministrat angles liberal e radikal, nji mori publicistash frances „perpârimtarë" (të cilet janë d'akord kryekrejet me publicistat e reakcjonit), nji mori shkrimtaresh llafazana të regjimeve, te kadetve dhe te pogresistave deri tek disa shkrimtarë llafazana rus-narodnik dhe „marksist"—në 1000 menyrë hartojnë kangë per lirin dhe pamvarsin e „Atdheut" —madhështin e parimeve te sovranitetit kombëtar. Nuk mund te merret vesh se ku marr fund kanga e kangëtarit te shitun tek xhelati Nikolla Romanov, ose ma mirë me thanë - torturuesi i zezakëve dhe banorve t'Indisë, e ku fillon mikroborgjezi me cilsina mediokriteti, i cili nga trashamanija ose pakarakttersija lëshohet „t'a tërheki rryma te poshtë". Kjo nuk ka randësi te diskutohet. Para nesh asht rryma shum e gjanë dhe shum e thellë e idesë, rranjet e së cilës janë te lidhuna shum fortë me interesat e zotnijve poseduesa

dhe kapitalistave te kombeve te medhaj. Per propagandën e idenave që ju vijnë përshtat këtyne klasave shpenzohen me qinda miljona ne vit: mullini asht i madh dhe e merr ujin nga te gjitha anët, tue fillue nga shovenistë i bindun Menshevikov e tue perfundue me shovenistat nga oportunizmi ose nga pa karakterësija, Plehonov dhe Mosllov, Rubanoviç dhe Smirnov, Kropotkin dhe Burcev.

Do të tentojmë edhe ne social demokratet Velikorus te caktojmë relacionin t'onë kundra kësaj rryme ideologjike. Neve, perfaqsuesvet te kombit te shtetit te madhë te Lindjes së largëme t'Europës dhe te nji pjesës së mirë t'Azisë nuk kishte me na pasë hije të harrojshim randesin e madhe te çeshtjes kombëtare, sidomos ne vendin që me plotë te drejtë e quejnë „Burgu i popujve", - ne kohën kur kapitalizmi po i ngjallë dhe po i banë te vetëdijshëm nji varg te tanë kombesh „të rij", te mëdhaj e të vegjël, pikërisht në Lindjen e larkëme t'Europës dhe n'Asia—ne momentin kur monarhija cariste ka armatosë me miliona Vélikorus dhe „të huej" per me „zgjidhë" nji varg çeshtjesh kombëtare ne harmoni me interesat e Këshillit të fisnikve të bashkuemë dhe të Guçkovëve, Krestovnikovëve, Dollkorukovëve, Kutlerave, Rodiçevave te ndryshëm.

Athue se per neve proletarët të vet-dijshem Velikorus asht e huej ndjenja e krenarisë kombetare? Mirret vesh se jo! Ne e duem gjuhen t'onë dhe atëdheun t'onë, re perpiqemi para së gjithave qe turmat e tija punonjëse (d. m. th. 9/10 të popullsisë së tij) t'i naltësojmë deri ne jeten e vetëdijshme të demokratëve dhe socialistave. Neve na dhembë në zemër kur shohim dhe ndigjojmë se nen çfarë përdhunime, shtypje dhe mundi-

me e nënshtrojnë atdheun t'onë të bukur xhelalët e carit, fisnikët dhe kapitalistat. Jemi krenarë që këto perdhunime kanë shkaktue rezistencën nga mesi i ynë, nga mesi i Velikorusëve, që ky mes dha Radishçevin, Dekabristët, revolucionarët-raznoçinca te shtatëdhetave, që klasa puntore Velikoruse fomoi ne vitin 1905 partin revolucionare të fuqishme të masave, që katundari Velikorus njikohësisht filloi me u ba demokrat, filloi me frëxue popin dhe poseduesin e madhë.

Neve na kujtohet, se si demokrati Velikorus Çernishevski, tue dhanë jetën e vetë për çashtjen e revolucjonit para gjysëm shekulli, tha: Komb i mjer komb i skllavëve, që nga naltë e deri poshtë vetëm skllavë. Skllavë të hapët dhe të mëshefët-Veliko-rusët (skllavë në relacion, me monarkin cariste) nuk duem t'i kujtojmë këto fjalë. E si mbas mendimit t'onë këto kanë qenë-fjalë të dashunisë së vërtetë ndaj atëdheut, të dashunisë që vajton pse nuk ka revolucionaritet ndër masa të popullsisë Velikoruse. Ai nuk ka ekzistue atëherë. Tash ka pakë, por ekziston.

Ne kemi plotë ndjenja krenarije kombëtare, sepse kombi i Velikorusve-krijoi gjithashtu klasën revolucionare, gjithashtu tregoi që asht i aftë me i dhanë shembuj të mëdhaj njerz'mit në luftën për liri dhe socializëm, e jo vetëm persekutime të mëdha, rradha litarësh, burgje, vjet zije dhe përuljen e madhe të skllavit para popave, carëve, çifliksahibive dhe kapitalistave.

Ne kemi plotë ndjenja krenarije kombëtare dhe pikrisht për këtë arsye e urrejmë veçanrisht të kaluemen t'onë „Skllave" (kur latifundistat,-fisnikët i çojshin katu-

ndarët në luftë për me shkelë lirin e Ungarisë, Polonisë, Persis, Kinës) dhe të sotshmen t'onë skllave kur po ata latifundista të ndihmuem nga kapitalistat, na çojnë në luftë për me shkelë Polonin dhe Ukrainën, për me-shkatrrue levizjen demokratike në Persi dhe në Kinë, për me forcue bandën e Romanovëve, Bobrinskëve, Purishkeviçve që e turpënon nderin t'onë kombëtarë Velikorus. Kërkush nuk asht fajtorë që ka lindë si skllav; por skllavi që e ka gja të huej, jo vetëm tendencën për lirin e tijë, por edhe justifikon e zbukuron skllavënin e tijë (për shembull shkeljen e Polonisë, Ukrajinës e tj. e çuen „mprojtje e atdheut" të Velikorusëve) ky skllav asht hysmeqar e i pa fytyrë që shkakton ndjenjën e drejtë të kundërshtimit, përbuzjes dhe mëninë.

„Populli që shtyp popuj tjerë ruk mund të jetë i lirë", kështu folën Marksi dhe Engelsi përfaqsuesat e mëdhaj të demokracisë së vërtetë të shekullit XIX-të, që u banë mësuesa të proletarjatit revolucionar. Edhe ne, puntorët velikorus, plotë ndjenja krenarije kombëtare, deshirojmë me ç'do kusht Velikorusin krenare, të lirë e të pamvarun, sovrane, demokratike, republikane, që ngren marrdhanjet e saja me fqinjët, në parimet njerzore të barasisë e jo në parimet feodale të privilegjeve, gja që e poshtënon kombin e madhë. Pikrisht pse e dëshirojmë ne themi: nuk mund të „mprohet at-dheu" në shekullin e XX te në Europë (bile as në Lindjen e larkëme t'Europës) ndryshe, përveç se tue luftue me të gjitha mjetet revolucjonare kundra monarkisë; latifundistave-dhe kapitalistave t'atdheut t'onë, d. m. th. kundra armiqve ma të këqij t'atdheut t'onë.

...Për revolucionin e proletarijatit asht i domosdoshëm edukimi i puntorve, që vazhdon shum kohë, me frymën e të drejtave të barabarta të plota kombëtare dhe me frymën e vllazënimit. Simbas kësaj, pikrisht nga pikpamja e interesave të proletarijatit velikorus, asht i domosdoshëm edukimi i masave drejtë mbrojtjes ma të vendosun, ma besnike, guximtare, revolucionare të të-drejtave të barabarta të plota dhe të së drejtës për vetëvendosje të të gjithë kombeve që i shtypin Velikorusët. Interesi (jo i kuptuem skllavërisht) i krenaris kombëtare të veliko-rusëve përputhet me interesin socialist të proletarve veliko-rus (dhe i të gjitthë të tjerve). Si shembull do t' na mbetet Marksi që me vite jetoi n' Angli dhe u ba gjysëm Anglez por me gjith këtë kërkoi lirin dhe pamvarsin kombëtare t' Irlandës, në interesin e lëvizjes socialiste të puntorve angles.

J. V. Stalin

Mbi shmangëjet ne fushen e çashtjes kombtare

Nga fjalimi i mbajtun në v. 1930, në Kongresin e XVI të P. K. (b.) të B.R.S.S-it.

Pasqyra e luftës kundra shmangëjevet në parti nuk ka me qenë e plotë, po qe se nuk i përmendim shmangëjet që ekzistojnë në parti në fushën e *çashtjes kombëtare.* Kam parasyshë, së pari, shmangëjen kah shovenizmi i Rusvet të mëdhaj dhe, së dyti, shmangëjen kah nacionalizmi lokal. Këto shmangëje nuk janë aq të dukshme dhe nuk bijnë aq fort në sy si shmangëja „e majtë" ase e djathtë. Mund të thuhej se këto shmangëje po sa kanë risë me qitë krye. Por kjo nuk don të thotë se ato akoma nuk ekzistojnë. Jo, ato ekzistojnë dhe, shka asht kryesore, po rriten. Këtu nuk mund të dyshohet aspak. Nuk mund të dyshohet, sepse atmosfera e përgjithshme e ashpërsimit të luftës së klasës duhet të sjellë pa tjetër njifarë ashpërsimi të përleshjevet kombëtare, të cilat pasqyrohen në parti. Prandaj kishte me u-dashtë me zbulue dhe me e nxjerrë në dritën e diellit fizionomin e këtyne shmangëjevet.

Kù qëndron substanca e shmangëjevet kah shovenizmi i Rusvet të Mëdhaj nder kushtet t'ona të sotshme?

Substanca e shmangëjevet kah shovenizmi i Rusvet të Mëdhaj qëndron në tendencën që të mos merren parasyshë ndryshimet kombëtare të gjuhës, kulturës, jetës; në tendencën që të pregaditet likuidimi i republikavet dhe krahinavet kombëtare; në tendencën që të vorroset parimi i barazis kombëtare dhe të bahet e pamundësi me politika e partis, qe asht: nacionalizimi i aparatit, nacionalizimi i shtypit, shkollavet dhe organizatavet të tjera shtetnore dhe shoqnore.

Shmangësat e këtij tipi, për të gjitha këto, nisen nga pikpamja se me fitoren e socializmit, kombet duhet të shkrihen në nji, ndërsa gjuhët e tyne kombëtare duhet të kthehen në nji gjuhë të përbashkët; se ka ardhë koha të likuidojmë ndryshimet kombëtare dhe t'a lamë politikën e ndihmës për zhvillimin e kulturës kombëtare të popujvet që përpara kanë qënë të shtypun. Ata kapën për Leninin, tue e citue për së mbrapshti e nga nji herë tue e përçudnue dhe tue i u shpifë direkt Leninit. Lenini ka thanë se në socializëm interesat e kombësivet do të shkrihen në nji tanësi, - a thue nga kjo nuk rrjedhë se asht koha t'i u jepet fund republikavet dhe krahinavet kombëtare n'interes të... Internacionalizmit? Në vitin 1913, në polemikën me bundistat, Lenini ka thanë se parolla e kulturës kombëtare asht parullë borgjeze, - a thue nga kjo nuk rrjedhë se asht koha me i dhanë fund kulturës kombëtare të popujve të B.R.S.S. n'interes të... internacionalizmit? Lenini ka thanë se socializmi zhdukë shtypjen kombëtare dhe muret kombëtare, - a thue nga kjo nuk rrjedhë se asht koha me i dhanë fund politikës që merrë parasysh veçorit kombëtare të popujve të B R.S.S.

dhe me kalue në politikën e asimilimit n'interes të... internacionalizmit? E tjera e tjera kësi soji.

Nuk ka dyshim se kjo shmangëje në çashtjen kombëtare, e mëshefun nën këtë maskë internacionalizmi e nën emnin e Leninit, asht forma ma e rafinuemja e, si rrjedhim, ma e rrezikshmja e nacionalizmit të Rusve të Mëdhaj.

Së pari, Lenini nuk ka thanë kurrë se duhet të zhduken ndryshimet kombëtare e se gjuhët kombëtare duhet të shkrihen në nji gjuhë të përbashkët mbrenda kufijve të nji shteti, para fitores së socializmit në përpjestime botnore. Për-kundrazi, Lenini ka thanë diçka krejtë të kundërt, d. m. th. se „ndryshimet kombëtare e shtetnore në mes të popujve dhe të vëndeve... do të qindrojnë gjithnji për nji kohë shum, shum të gjatë, bile edhe mbas vendosjes së diktaturës së proletariatit në përpjestime botnore v. XXV, faqe 229. A thue asht e mundun me u bazue në Leninin, tue harrue këtë udhëzim themeluer?

Vërtetë, nji nder ish-marksistat, tash renegat (mohues) e reformist, z. Kautski pohon diçka bash të kundërt me atë që na mëson Lenini. Në kundërshtim me Leninin, ai pohon se fitorja e revolucionit proletar në shtetin e bashkuem austro-gjerman, në mesin e shekullit të kaluem, do të sillte formimin e nji gjuhe gjermane të përbashkët dhe gjermanizimin e Çekve, mbassi „vet forca e librueme nga shtërngesat e shkëmbimit, vet forca e kulturës moderne, që kanë sjellë me vedi gjermanët pa kurfar giermanizimi të përdhunshëm, *do t'i kthente në gjermani mikroborgjezët, fshatarët e*

proletarët e mbrapametun Çekë, të cilëve nuk ka mujt me i u dhanë kurrgja kombësija e tyne e dobsueme. (Shif parathanjen e botimit gjerman „Revolucioni e kundrarevolucioni"). Asht e kjart se ky far „koncepti" harmonizohet plotësisht me social-shovenizmin e Kautskit. Kundra kësaj pikpamje të Kautskit kam luftue në vitin 1925 në fjalimin t'em të mbajtun n'universitetin e popujve të lindjes. Por, për ne marksistat, që duem të qindrojmë deri në fund internacionalista, a thue mund të ketë ndonji far randësije kjo llafazanëri anti-marksiste e këtij social-shovenisti të tërbuem gjerman? Kush ka të drejtë - Kautski a po Lenini? Po qe se ka të drejtë Kautski, atëherë, me ç'ka spjegohet fakti që kombësit relativisht të mprapametuna, si Rusët e Bardhë e Ukrajinët, të cilët janë ma afër Rusvet të Mëdhaj se sa Çekët me Gjermanët, nuk janë rusizue, me gjithë fitoren e revolucionit proletar në B.R.S.S., por, përkundrazi, janë rilindë dhe zhvillue si kombe në vehte? Si të shpjegohet fakti që kombet, si Turkmenët, Kirgizët, Uzbekët, Taxhikët, (që të mos folim ma edhe për Gjurgjianët, Ermenët, Azerbejxhanët e tj.), me gjithë mrapambetjen e tyne, nuk janë rusizue me fitoren e socializmit në B.R.S.S., por, përkundrazi, janë rilindë dhe zhvillue si kombe në vehte? A thue s'asht e kjartë se (hmangësat t'onë të ndershëm), tue kërkue internacionalizmin formal, kanë ra në duer të social-shovenizmit Kautskist? A thue s'asht e kjartë se, tue luftue për nji gjuhë të përbashkët mbrenda kufijve të nji shteti, në kufijt e B.R.S.S., ata, në substancë, kërkojnë me përtri p r i v i l e g j e t e gjuhës që përpara ka sundue, d. m. th. gjuhës së Rusve të Mëdhaj?

E dyta, Lenini nuk ka thanë kurr se zhdukja e shtypjes kombëtare dhe shkrimja e interesave të kombësive në nji tansi asht identike me zhdukjen e ndryshimeve kombëtare. Na kemi zhdukë shtypjen kombëtare, kemi zhdukë privilegjet kombëtare dhe kemi vendosë barazinë kombëtare. Na i kemi zhdukë kufit shtetnorë në kuptimin e vjetër të fjalës, gurtë e kufive dhe pengesat doganore në mes të kombësive të B.R.S.S. Kemi vendosë unitetin e interesave ekonomike e politike të popujve të B.R.S.S.. Por a thue kjo don të thot se me këtë kemi zhdukë ndryshimet kombëtare, gjuhët, kulturën, mënyrën e jetesës së kombësive e tj.? Asht e kjartë, se jo. Por në se ndryshimet kombëtare, gjuha, kultura, jetesa e tj., mbesin, a thue nuk asht kjo e kjartë se kërkesat për zhdukjen e republikave dhe krahinave kombëtare, në periudhën e tashme historike, janë kërkesa reakcionare, të drejtueme kundra interesave të diktaturës së proletarjatit? A kuptojnë a thue shmangësat t'onë se me i zhdukë tashti republikat e krahinat kombëtare d. m. th. me u a hjekë milionave të turmave të popujve të B.R.S.S. mundësin që të lavrohen në gjuhën a m t a r e, me u a hjekë mundësin që të kenë shkollën, gjygjin, administratën, organizatat dhe institutet shoqnore e tjera në gjuhën a m t a r e, me u a hjekë mundësin që të bahen pjesmarrësa të ndertimit socialist? A thue nuk asht e kjartë se shmangësat (deviatorët) t'onë tue kërkue internacionalizmin formal, kanë ra në kurthë të shovenistave reakcionarë Rusë të Mëdhaj dhe kanë harrue, kanë harrue kryekput, parullën e revolucionit kultural në periudhën e diktaturës së proletarjatit, e cila ka forcë të barabartë për të gjithë

popujt e B.R.S S., si për ata Rusë të Mëdhaj ashtu dhe për ata jo-Rusë të Mëdhaj?

Së treti, Lenini nuk ka thanë kurrë se parulla për zhvillimin e kulturës kombëtare, në kushtet e diktaturës së proletarjatit, asht parullë reakcionare. Perkundrazi, Lenini ka qenë gjithmonë i mendimit që popujve të B.R S.S. duhet me u ndihmue që të zhvllojnë kulturen e tyne kombëtare. Nen udhëhejen e Lenjinit, dhe jo nen udhëheqjen e ndonji tjetrit, asht perpilue dhe asht pranue, në kongresin e X, të partis, rezolucioni mbi çashtjen kombëtare, ku thohet drejtë për së drejti se:

"Detyra e partis qindron këtu: t'u ndihmojë turmave punojsë të popujve jo — Rusë të Mdhaj që t'a arijnë Rusin Qendrore ma të perparueme, e cila ka shkue ma largë, t' u ndihmojë:

a) Që të zhvillojnë e të perforcojnë qeverimin sovjetik në forma që u pergjigjen kushteve kombëtare dhe mënyres së jeteses s'atyne popujve;

b) Që të zhvillojnë dhe të perforcojne në gjuhen e tyne amtare gjyqin, administraten, orgënet e ekonomis, organet e pushtetit, të perbame nga banoret vendas, që njohin mënyren e jeteses dhe psikologjin e populsis së vendit;

c) Që të zhvillojnë shtypin, shkollen, teatrin, klubet dhe institutet kulturore — arsimore, përgjithësisht, në gjuhen e tyne amtare;

d) Që të krijojnë dhe te zhvillojnë rrjeten e gjanë të kurseve e shkollave, per kulturen e pergjithëshme ashtu dhe shkollat me karakter profesional — teknik në gjuhen

e tyne amtare."

A thue nuk asht e kjartë se Lenjini ka qenë, në tansi e kryekput, per parullen e zhvillimit të kultures kombëtare nëkushtetediktaturessë prolatarjatit?

A thue nuk asht e kjartë se mohimi i parulles për kulturen kombëtare në kushtet e diktatures së proletarjatit don te thot mohim i doemosdoshmenis së naltësimit kultural të popujve jo — Rusë të Mëdhaj të B.R.S.S., mohim i doemosdoshmenis së lavrimit të pergjithëshëm te detyrueshem per këta popuj; se don te thot më i a dorëzue këta popuj skllavnis shpirtnore të nacionalistave rëakcionarë.

Pernimend Lenjini e ka kualifikue (cilësue) parullën e kultures kombëtare nen sundimin e borgjezis si parullë reakcionare. Por, a thue mund të bahej ndryshej?... Ç'ka asht kultura kombëtare nën sundimin e borgjezis kombëtare? Kulturë borgjeze, për kah permbajtja e sajë, kombëtare, për kah forma e sajë, ka për qëllim me i helmue turmat me helmin e nacionolizmit dhe me përforcue pushtetin e borgjezis. Ç'ka asht kultura kombëtare nën diktaturën e proletarjatit? Kultura socialiste, për kah përmbajtja e sajë kombëtare, per kah forma e sajë, ka për qëllim me i edukue turmat me frymën e internacionalizmit che me përforcue diktaturën e proletarjetit. Si murd të përzihen këto dy çfaqje parimisht të ndryshme, tue mos u largue nga marksizmi? A thue s'asht e kjartë se, tue luftue kundra parullës së kulturës kombëtare në sistemin borgjez, Lenini ka atakue përmbajtjen borgjeze të kulturës kombëtare dhe jo formen e sajë kombëtare? Do t'ishte marri me presupozue se Lenini e shiqonte kulturën

socjaliste si jo-kombëtare, që s'i ka këto ase ato forma kombëtare. Bundistat, përnjì mend, i a kanë pasë pshtetë në nji kohë Leninit këtë marri. Por nga veprat e Leninit dihet se ai ka protestue rreptazi kundra shpifjeve të tilla, tue u-shporrë vendimtarisht prej kësej marrëzije A thue shmangësat t'onë të ndershëm, prap se prap karë ndjekë gjurmat e bundistavet?

Mdas te gjitha këtyne që thamë, shka ka mbetë nga argumentat e shmangësavet t'onë?

Kurrgja, përveç lojes me flamurin e interracjonalizmit dhe shpifjevet kundra Leninit.

Ata, që shmangen në drejtim të shoverizmit të Rusvet të Mëdhaj, mashtrohen këqas kur kujtojnë se perjudha e ndertimit të socjalizmit rë B.R.S.S. asht perjudha e dekadencës dhe likuidimit të kulturave kombëtare.

Puna qëndron bash përkundrazi. Në realitet, periudha e diktatures së proletarjatit dhe ndertimit socjalist n'U.R.S.S. asht perjudha e lulëzimit të kulturavet kombtare, socjaliste-për kah përmbajtja, dhe kombtare-per kah forma. Ata, natyrisht, nuk kuptojrë se kulturat kombtare duhet të zhvillohen me nji forcë të re, me futjen dhe rranjësimin e kulturës së përgjithshem themeltare të detyrueshme ne gjuhen amtare. Ata nuk kuptojnë se vetem nën kushtet e zhvillimit të kulturavet kombtare do të jetë e mundun me terhjekë, përnjimend, kombësit e mbrapambetuna që të marrin pjesë në ndertimin socjalist. Ata nuk kuptojnë se bash këtu qëndron baza e politikës leniniste të ndihmës e të përkrahjes së zhvillimit të kulturavet kombtare te popujve të B.R.S.S.

Mund të duket çudi se si na, antarët e shkriemjes

s'ardhëshme te kulturave kombëtare në nji kulturë të perbashkët (si kah forma ashtu edhe per kah permbajtja), me nji gjuhë të përbëshkët, njikohësisht jemi edhe antarë të lulëzimit të kulturave kombëtare në çastin e tanishem, në periudhen e diktatures së proletariatit. Por këtu nuk ka kurrgja të çuditëshme. Duhet me i u lejue kulturave kombëtare që të zhvillohen e të lulëzojnë, të shprehin të gjitha aftësitë e veta, të krijojnë kushtet per shkrimjen e tyne në nji kulturë të perbashkët, me nji gjuhë të perbashkët. Lulëzimi i kulturave, kombëtare per kah forma e socialiste per kah permbajtja në kushtet e diktatures proletarijatit në nji vend, me qellimin e shkrimjes së tyne në nji kulturë socialiste (si per kah forma ashtu edhe per kah permbajtja), me nji gjuhë të perbashkët, kur proletarjati ngadhnjen në të gjithë botën dhe socijalizmi hynë në jetën e perditëshme, - zaten këtu qindron dialekticiteti i paraqitjes lenjiniste të çashtjes së kultures kombëtare.

Ndokush mundë të thotë së këjo far paraqitjeje e çashtjes asht „konrtadiktore". Por, a thue nuk kemi nji po kësi „kontradite" në çashtjen e shtetit? Na jemi per shkrimjen e shtetit. Dhe njikohësisht na jemi per forcimin e diktatures së proletarjatit, e cla paraqet pushtetin ma të fuqishem dhe ma të fortë nga të gjitha pushtetet shtetnore që kanë ekzistue deri tash. Zhvillimi ma i nalt i pushtetit shtetnuer - këjo asht formula marksiste. A asht këjo „kontradiktore"? Po, „kontradiktore". Por ky kontradiksion asht jetësuer (vital), dhe në këte pasqyrohet plotësisht dijalektika e Marksit.

Ose t'a marim, pershembëllë paraqitjen Lenjiniste të çashtjes mbi të drejten e kombeve per vet vendosje deri në çkputje të plotë. Ka nji herë Lenjini e paraqiste tezen e vet-vendosjes kombëtare ne formen e formules së thjeshtë „ndamje me qellim bashkimi". Mendoni nji herë! Ndamje me qellim bashkimi. Këjo i pergjet bile nji paradoksi. Kurse, këjo „formulë kontradiktore!" permban atë të vertetë jetësore të dialektikes së Marksit, e cila u jep mundësi bolshevikve me marrë fortifikatat ma të pazaptueshme ne fushen e çashtjes kombëtare.

Po këjo duhet të thohet edhe per formulen në lidhje me kulturen kombëtare: lulëzimi i kultures kombëtare (dhe gjuhve) ne periudhen e diktatures së proletarjatit në nji vend, me qellim pregatitjeje të kushteve socialiste (dhe në nji gjuhë të perbashkët) në periudhen e fitores së socializmit në mbarë boten.

Ai që nuk e ka kuptue ketë origjinalitet e "kontraditë" të fazes s'onë tranzitore (kalimtare), ai që nuk e ka kuptue ketë dialektikë të proçesevet historike, ai ka mbarue për Marksizmin.

Fatkeqsija e shmangsavet t'onë qindron në faktin se ata nuk kuptojnë e nuk duen t'a kuptojnë dialektiken e Marksit.

Kështu qindron puna me shmangëjen kah shovenizmi i Rusve të Mdhaj.

Nuk ash zor me kuptue se në ketë shmangëje pasqyrohet tendenca e klasave te falimentueme të kombit të Rusvet të Mdhaj, dikur sundues, që të këtheji ë privilegjet e tyne te humbuna.

Prej këndej, rreziku i shovenizmit të Rusve të Mdhaj, si rrezik kryesuer i partis në fushen e çashtjes kombëtare.

Ku qindron substanca e shmangëjës kah nacionalizmi lokal?

Substanca e shmangëjes kah nacionalizmi lokal qindron në tendencen që të ndahet dhe të mbyllet në kuadrin e levozhges së vet kombtare, në tendencen që të mshefen kontraditat e klases në kombin e vet, ne tendencen per mbrojtjen nga shovenizmi i rusve të mbdhaj me anen e largimit nga rrjedhja e pergjithshme e ndertimit socialist, në tendencen që të mos shifet ajo që i afron dhe i bashkon turmat punojse te kombsive të BRSS, por të shifet vetem ajo që mund t'i largojë njenen nga tjetra.

Shmangëja kah nacionalizmi lokal pasqyron paknaqsin e klasëve te falimentueme te kombesive, dikur te shtypuna, ndaj regjimit të diktatures së proletariatit, tendencen e tyne që të ndahen në shtetin e tyne kombtar dhe atje t'a vendosin sundimin e tyne të klases.

Rreziku i kësaj shmangeje qindron ne faktin se ajo kultivon nacionalizmin borgjez, dobson bashkimin e punojsve te popujve te bashkimit Sovjetik e u-bjen per shtat intervencionistave.

Kjo asht substanca e shmangëjes kah nacionalizmi lokal.

Detyra e Partis asht: me zhvillue nji luftë vendimtare kundra kësaj shmangëjeje e me sigurue kushtet e domosdoshme për edukaten internacionale të turmave punonjse të popujve të BRSS.

(Nga „Borba" Nr. 9, viti 1945).

J. V. Stalín

Mbi çeshtjen nacionale në Jugosllavi

Shokë!

Unë kujtoj se Semiqi nuk e ka krej të qartë esencën e parashtrimit bolshevik te çeshtjes nacionale. Bolshevikët nuk e kanë nda kurrë çeshtjen nacionale nga çeshtja e pergjithshëme e revolucionit, as para Tetorit as mbas Tetorit. Esenca e trajtimit bolshevik te çeshtjes nacionale qindron ne faktin se bolshevikët e kanë shikue gjithëmonë çeshtjen nacionale ne lidhje te pa-ndame me perspektivën revolucionare.

Semiqi citon Leninin, tue thanë se Lenini ka qenë i mejtimit se nji pjesë e zgjidhjes së çeshtjes nacionale duhet caktue me konstitutë. Si duket, Semiqi me këtë ka dashtë të thotë se Lenini e konsideronte çeshtjen nacionale si nji çeshtje konstitucionale, d. m. th. jo si çeshtje revolucionare, por si nji çeshtje reforme. Kjo asht krejt gabim. Lenini nuk ka vuejtë kurr dhe as që ka mund të vuej nga iluzionet konstitucionale. Mjafton vetëm të shfletzohen shkrimet e tija që n'eriu të bindet për këtë fakt kur Lenini ka folë për konstitutë, nuk ka pasë parasysh udhën konstitucionale per të zgjidhë çeshtjen nacionale, por udhën revolucionare d. m. th. ai e

ka shikue konstitucionin si rezultat të triumfit të revolucionit. Edhe na në Bashkimin Sovjetik kemi nji konstitutë, edhe në këtë pasqyrohet nji farë zgjidhjeje e çeshtjes nacionale. Por kjo konstitutë nuk ka ardhë si rjedhim i ndonji marrëveshtjeje me borgjezinë, por si rezultat i revolucionit triumfues.

Ma tutje Semiqi i riferohet broshurës së njoftun të Stalinit mbi çeshtjen nacionale, të shkrueme me 1912 dhe në te perpiqet të gjejë së pakut ndonji provë indirekte për vërtetimin e konceptit të tij. Por ky riferim nuk pat rezultat mbasi në këtë broshurë, jo vetëm që nuk gjeti ndonji citat, por as ndonji aluzion të largët, që t'a justifikonte trajtimin e tij „konstutitucional" te çeshtjes nacionale. Natyrisht se nji gja të tillë as që mund t'a gjente në këtë broshurë. Për vërtetim Semiqit mund t'i a kujtoj pasazhin e njoftun të broshurës së Stalinit, në të cilin paraqitet methoda e marksistave rusë (methoda revolucionare) në kundërshtim me methodën austriake të zgjidhjes së çeshtjes nacionale (methoda konstitucionale). Ky pasazh thotë:

> „Austriakët besojnë se mundë t' a realizojnë „lirin nacionale" me anën e reformave të vogëla, me hapa të ngadalëshem. Kur propozojne autonominë nacionale si nji masë praktike, ata nuk marrin aspak para-sysh ndryshimin themeltar, lëvizjen demokratike çlirimtare; atyne përgjithësisht u mungon kjo prespektivë. Kurse marksistat rusë çeshtjen e „lirisë nacionale" e lidhin me ndryshimin radikal që ka mundësi të ngjajë, me lëvizjen çlirimtare demokratike, mbasi nuk kanë asnji arsye të mbështeten ndër

reforma. Dhe kjo e ndryshon me themel çeshtjen për sa i përket fatit të nacioneve në Rusi".

Kjo asht e qartë.

Dhe kjo nuk asht pikëpamja personale e Stalinit, por pikëpamja e pergjithëshme e marksistave rusë, të cilët e kanë shikue dhe e shikojnë gjithënji çeshtjen nacionale në lidhje të pa-ndame me çeshjen e pergjithëshme të revolucionit.

Mund të thuhet fare lehtë se paraqitja e çeshtjes nacionale në historin' e marksizmit rus ka kalue dy stade: stadin e parë — deri në Tetuer, dhe stadin e dytë — gjatë Tetorit. Në stadin e parë çeshtja nacionale shikohej si nji pjesë e çeshtjes së pergjithëshme të revolucionit demokratik borgjez, d.m.th. si nji çeshtje e diktatures së proletariatit dhe e fshatarësisë.

Në stadin e dytë, kur çeshtja nacionale u-zgjanue dhe u-ba edhe çeshtje e kolonive, kur çeshtja nacionale, nga nji çeshtje e mbrendëshme shtetnore, u-transformue në nji çeshtje botnore, atëherë kjo u-shikue si nji pjesë e çeshtjes së pergjithëshme të revolucionit proletar, si nji pjesë e çashtjes së diktaturës së proletariatit. Si ç' shifet, si atje, ashtu edhe këtu, çeshtja asht trajtue në mënyrë krejt revolucionare.

Unë mendoj se Semiqi akoma nuk i ka të qarta të gjitha këto. Nga kjo rrjedh edhe tentativa e tij që t'a drejtojë çeshtjen nacionale në terenin konstitucional, d.m.th. t'a shikojë si nji çeshtje reforme.

Nga ky gabim del edhe gabimi tjeter i Semiqit, i cili qindron në faktin se ky nuk don të pranojë se çeshtja nacionale, n'esencë asht çeshtje fshatare. Jo çesh-

tje agrare, por pikërisht çeshtje fshatare, mbasi këto janë dy çeshtje të ndryshme. Me të vertetë asht krejt e qartë se çeshtja nacionale nuk mund t'identifikohet me çeshtjen fshatare, mbasi çeshtja nacionale, perveç çeshtjes fshatare, perfshinë edhe çeshtjen e kultures nacionale, te shtetësisë nacionale etj. Por s'ka asnji dyshim se bazen e çeshtjes nacionale, esencen e sajë, e perban çeshtja fshatare. Dhe kjo spjegon dhe shkakun pse ushtrinë kryesore të lëvizjes nacionale, e perban fshatarësija, pse pa këtë ushtri fshatare nuk ekziston, as që mund t'ekzistojë, nji lëvizje e fortë nacionale. Në të verteten kjo merret parasysh, kur thuhet se çeshtja nacionale, n'esencë asht çeshtje fshatare. Unë mendoj se ne refuzimin e Semiqit që të pranojë këtë formulim mëshifet nënçmimi i fuqisë së mbrëndshme të lëvizjes nacionale dhe mos-kuptimi i karakterit thellësisht popullues dhe thellësisht revolucionar i lëvizjes nacionale. Ky mos-kuptim dhe ky nënçmim paraçet rrezik te madh, mbasi ky praktikisht don të thotë nënçmim i fuqis së mbrendshme të potencialit, që gjindet, të thomi, në lëvizjen e lirisë nacionale të Kroatëve; nënçmim që mund t'i sjelli perfundime të këqija të tanë Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Këtu qindron gabimi i dytë i Semiqit. Edhe tentativa e Semiqit që t'a shqyrtojë çeshtjen nacionale ne Jugosllavi të çkëputun nga pozita internacionale dhe nga perspektivat e mundshme n'Europë, duhet konsiderue pa dy him e gabueshme. Tue u nisë nga fakti, se ne momentin e tanishëm në Kroaci dhe në Slloveni nuk ekziston ndonji lëvizje popullore serioze për pavmarësi, Semiqi arrinë të përfundojë se çeshtja e së drejtës nacionale per

çkëputje asht nji çeshtje akademike dhe jo aktuale. Kjo natyrisht, asht e gabueshme. Edhe sikur të pranojmë se kjo çeshtje tanì per tanì nuk asht aktuale, prap se prap kjo mund të bahet krejt aktuale kur te fillojë ose posa të fillojë lufta, kur n'Evropë të pëlcasi revolucioni, ose ma mirë, posa te pëlcasi revolucioni. Dhe se do të fillojë me doemos lufta dhe se ata do të perleshen atje, me doemos, kjo s'ka dyshim, nëse do të kemi para-sysh natyrën dhe zhvillimin e imperializmit.

Në vjetin 1912, kur na, marksistët rusë, bamë nji skicë të propozimit të parë të programit nacional, na akoma n'asnji krahinë kombetare të perandorisë ruse nuk kishim ndonji lëvizje serioze për pamvarësi. Me gjith' atë na e kemi pamë të nevojshme të fusim në programin t'onë pikën mi të drejtën e nacioneve për vetëvendosje, d. m. th. mi të drejtën që ka çdo nacionalitet të çkëputet dhe të ketë shtetin e tij të pamvarun. Pse? Nga se nuk jemi nisë vetëm nga ajo që eksistonte atëherë, por edhe nga ajo që po zhvillohej dhe po piqej në sistemin e përgjithëshëm të marrëdhanjeve internacionale, d.m. th. ne atëherë nuk mbështeteshim vetëm në të tashmën, por edhe në t'ardhmën. Dhe na e dijshim se marksistat rusë, në rast se ndonji nacionalitet do të kërkonte të çkëputej, do të luftojshin në mënyrë që çdo nacioni të tillë t'i sigurohej e drejta për çkëputje. Në fjalimin e tij Semiqi ka përmendë disa herë broshurën e Stalinit mbi ceshtjen nacionale. Por ja se ç'thuhet në këtë broshurë në lidhje me vetëvendosje dhe pamvarësi:

„Rritja e imperializmit n'Evropë nuk asht diçka e rastit. Kapitali e ndjen veten të ngushtuem n'E-

vropë dhe ky futet ndër vendet e huej, tue kërkue tregje te reja, puntorë me pagesa të vogëla, pikë mbështetje të reja. Kjo shkakton komplikacione të jashtëme dhe luftën. Ka plot mundësi të vërtetohet nji rast i tillë konditash të mbrendeshme dhe të jashtëme, ku ky ose ai nacionalitet i Rusisë do t'a shofi të mundun të parashtrojë dhe t'a zgjidhi çeshtjen e pamvarësis së tij. Dhe natyrisht se marksistave nuk u perket aspak që të nxjerrin pengesa në të tilla raste".

Këto janë shkrue që më 1912. Ju e dini se ky qendrim asht justifikue plotësisht me kohë, si gjatë luftëz si dhe mbas sai, sidomos mbas triumfit të diktaturës së proletariatit në Rusi.

Aqë më tepër duhet të merren para sysh këto mundësi për Evropën përgjithësisht, dhe Jugosllavinë veçanërisht, sidomos sot që lëvizja revolucionare çlirimtare asht thellue nder vendet e shtypun dhe që revolucioni ka triumfue në Rusi. Duhet marrë para sysh edhe rrethana se Jugosllavija nuk asht nji vend krejt indipendent, por asht i lidhun me disa grupe imperialiste dhe se nga ky shkak nuk mund të ndahet nga ajo lodër e madhe forcash që luhet jashtë Jugosllavisë. Dhe kur përpilloni programin nacional për partinë jugosllave - dhe në këtë rast asht çeshtja pikërisht këtu - duhet të mejtoni se programi nuk duhet të mbështetet vetëm në çeshtjet e momentit, por edhe n' ato që zhvillohën dhe që do të vijnë me doemos si konsekuencë e marrëdhanieve internacionale. Ju, pse unë mendoj se çeshtja e së drejtës së nacioneve për vetë - vendosje duhet konsiderue

si çeshtje aktuale, çashtje e ditës.

Tani mi programin nacional. Pikënisja e programit nacional duhet të jetë theza e revolucionit sovjetik në Jugosllavi, theza, se pa përmbysjen e borgjezisë dhe triumfin e revolucionit nuk mund të zgjidhet as çeshtja nacionale në mënyrë pak-a-shumë të kënaqshëme. Natyrisht se mund të ketë përjashtime. Kështu për shembull nji përjashtim ka qenë ndamja e Norvegjisë nga Suedija para lufte, mbi të cilën flet Lenini gjatë e gjanë në nji artikull. Por kjo ka ngja para lufte dhe në kondita jashtëzakonisht të favorshëme. Mbas lufte, dhe sidomos mbas triumfit të revolucjonit sovjetik në Rusi, raste të tilla do të jenë pothuejse të pamunduna. Ne ç'do rast, perspektivat për këto mundësi sot janë aqë të vogla, sa që mund të thuhet se janë hiç. Dhe në se qindron puna kështu, na nuk mund t'i përpilojmë programet t'ona tue ubazue mbi mundësina që janë barazi me hiç. Prandaj theza e revolucionit duhet të jetë pikënisja e çeshtjes nacionale.

Për ma tepër. Në programin nacional duhet të futet me doemos si pikë e veçantë çeshtja e së drejtës së nacioneve për vetëvendosje deri në çkëputje shtetnore. Unë fola ma naltë se për ç'arsye marrëdhaniesh të ndërsbrendëshme dhe të jashtëme të soçme kjo pikë nuk mund të kapërcehet.

Ma në fund, programi duhet të përmbajë dhe nji pikë të veçantë për autonominë nacionale-teritoriale t'atyne nacionaliteteve të Jugosllavisë, që nuk do t'a shofin të nevojshëme çkëputjen nga Jugosllavija. Nuk kanë të drejtë ata që thonë se nji kombinacion i tillë duhet t'ekskludohet. Kjo gja asht gabim. Në disa kondita

të caktueme, mbas triumfit të revolucionit sovjetik në Jugosllavi, ka mundësi të plotë që disa nacionalitete të Jugosllavisë mos dëshirojnë të çkëputen, siç ka ngja tek na në Rusi. Asht krejt e qartë se për këtë rast, programi duhet të ketë nji pikë të veçantë për autonomi, në lidhje me transformimin e shtetit Jugosllav në federatë shtetesh autonome nacionale si mbas sistemit sovjetik.

Pra të drejtë çkëputjeje për ato nacionalitete që do të dëshirojnë të çkëputen, dhe të drejtë autonomije për ato nacionalitete, që do të dëshirojnë me tepër të rrijnë në kuadrin e shtetit Jugosllav.

Që t'evitohen mosmarrëveshtjet due të theksoj se e drejta e çkëputjes nuk duhet të kuptohet *si angazhim*, si detyrë e çkëputjes. Nji nacionalitet mund t'a shfrytzojë këtë të drejtë në kuptim të çkëputjes, por mundet edhe mos t'a shfrytzojë, dhe nëse nuk dishron kjo asht punë për te dhe kjo duhet të merret para-sysh. Disa shokë e transformojnë të drejtën e çkëputjes në angazhim, tue kërkue, p. sh. prej Kroatëve që të çkëputen *me ç'do kusht*. Ky qendrim asht i gabueshëm dhe duhet të flaket. E drejta nuk duhet të ngatrrohet me angazhimin.

J. V. Stalin

Edhe nji herë mbi çeshtjen nacionale

Asht vetëm për t'u përshëndetë fakti që Semiqi tashti, mbas diskusionit që u-ba në komisionin Jugosllav, në nji artikull te tij asht pajtue me pikëpamjen e delegacionit të PKR në komintern. Por do t'ishte gabim të mendohej se në mes të delegacionit të PKR dhe Semiqit nuk ka pasë asnji divergjencë, as para diskusionit, as gjatë diskusionit në komisjonin Jugosllav. Si duket, Simiqi asht i prirun që t'i kuptojë kështu divergjencat në çeshtjen nacionale, tue ngulë kambë që t'i kthejë në mosmarrëveshtje. Mjerisht ky gabohet shum. N'artikullin e tij ky thotë se polemika kundra tij mbështetet në „nji varg mosmarrëveshtjesh" që ianë shkaktue vetëm nga „përkëthimi inkomplet" i fjalimit që bani në komisjonin Jugosllav. Me fjalë të tjera don të thotë se krejt fajin e ka përkëthyesi, i cili kush di se për çfarë arsyeje nuk e ka përkëthye si duhet fjalën e Semiqit. Për hir të së vërtetës jam i detyruem të deklaroj se këto pohime të Semiqit nuk i përgjigjen aspak së vërtetës. Do të kishte qenë shum ma mirë sikur Semiqi t'a kishte forcu këtë pohim me citate të nxjerruna nga fjalimi që mbajti në komisjonin Jugosllav, mbasi ky gjindet i stenografuem n'arkivat e Kominternit. Por ky nuk e bani këtë për

ndonji arsye. Prandaj në vend të Semiqit, jam i detyruem unë t'a marr përsipër këtë procedurë sigurisht jo të pëlqyeshme, por absolutisht të nevojëshme.

Kjo gja asht aqë ma e nevojëshme, mbasi edhe sot, me gjithëse Semiqi asht solidarizue plotësisht me pikëpamjen e delegacionit të PKR, kanë mbetë shumë pika t'errëta në pikëpamjen e tij.

Në fjalimin t'im në komisjonin Jugosllav unë kam folë mbi divergjencat e tri çeshtjeve: 1) mbi udhën e zgjidhjes së çeshtjes nacionale; 2) mbi përmbajtjen e mbrendëshme sociale të lëvizjes nacionale n'epokën e sotshme historike; dhe 3) mbi rolin e momentit internacional në çeshtjen nacionale.

Përsa i përket çeshtjes së parë unë kam theksue se Semiqi „nuk e ka krejt të qartë esencën e parashtrimit bolshevik të çeshtjes nacionale" se ky e ndanë çeshtjen nacionale nga çeshtja e përgjithëshme e revolucionit. Se ky pra ndjek atë udhë e cila e katandis çeshtjen nacionale në çeshtje konstitucionale.

A nuk janë të gjitha këto të vërteta?

Lexuesi mund të këndojë këtë pasazh të fjalimit që mbajti Semiqi në komisjonin Jugosllav (30 Mars 1925) dhe t'a çmojë vetë:

„A mund të zbritet çeshtja nacionale në nji çeshtje konstitucionale? Po e vemë pyetjen pikë së pari krejt theoritikisht. Po e zamë se në shtetin X rrojnë tri nacione, A, B, dhe C. Këto tri nacione çfaqin dëshirën të rrojnë së bashku në nji shtet. Ku qindron puna ne këtë rast? Natyrisht këtu asht puna të rregullohen raportet e mbrendëshme në kuadrin e këtij shteti. Pra këtu

kemi të bajmë me çeshtje konstitucioni. Në këtë rast theorik çeshtja nacionale këthehet në nji çeshtje konstitucionale... Në se në këtë rast theorik e këthejmë çeshtjen nacionale në nji çeshtje konstitucioni, atëherë duhet të themi-dhe unë gjithëmonë e kam theksue-se e drejta e nacioneve për vetëvendosje deri në çkëputje asht kondita preliminare për zgjidhjen e çeshtjes konstitucionale. Vetëm në lidhje me këtë unë e parashtroj çeshtjen konstitucionale".

Unë mendoj, se kësaj pikëpamje që shpreh Semiqi në fjalimin e tij nuk asht nevojë t'i bahet ma asnji koment. Asht e qartë se ai që e konsideron çeshtjen nacionale si nji pjesë përbamëse te çeshtjes së përgjithëshme të revolucionit Sovjetik, nuk mund t'a katandisi çeshtjen nacionale në çeshtje konstitucionale. Dhe anasjelltas: çeshtjen nacionale mund t'a katandisi në çeshtje konstitucionale vetëm ai, që e ndanë nga çeshtja e përgjithëshme e revolucionit proletar.

Në fjalimin e Semiqit shofim nji pjesë në të cilën thuhet se e drejta e vetëvendosjes nacionale nuk mund të fitohet pa luftën revolucionare. Semiqi thotë: „Merret vesht se kjo e drejtë mund të fitohet vetëm me luftën revolucionare. Kjo nuk mund t'arrihet me udhën parlamentare, por vetëm me aksjonet revolucionare të masave". Por ç'don të thotë „luftë revolucionare" dhe „aksjon revolucionar"? A mund t'identifikohet „lufta revolucionare" dhe „aksjoni revolucionar" me rrëzimin e klasës sunduese, me marrjen e pushtetit, me triumfin e revolucionit që asht konditë preliminare për zgjidhjen e çeshtjes nacionale?

Natyrisht se jo. Këto janë dy sende të ndryshme. Tjetër çeshtje asht kur thuhet se triumfi i revolucionit asht konditë kryesore për zgjidhjen e çashtjes nacioaale, e tjetër çashtje asht kur vihet si konditë preliminare për zgjidhjen e problemit nacional „aksjoni revolucionar" dhe „lufta revolucionare". Duhet të shënohet se udha e reformave, udha konstitucionale nuk eksludon aspak „aksjonet revolucionare" dhe „luftën revolucionare". Ato që caktojnë karakterin revolucionar ose reformist të kësaj ose të asaj partije, nuk janë aksjonet revolucionare decizive në vetë-vehte, por qëllimet dhe detyrat politike, për të cilat partija i kryen ose i përdorë këto aksjone. Si ç'dihet menshevikët rusë, më 1906 propozojshin që, mbas shpërndamjes së Dumës së parë, t'organizohej nji „grevë e përgjithëshme", dhe bile nji „kryengritje e armatosun". Por kjo nuk i pengoi që të mbeten menshevikë. Me ç'farë qëllimi i propozuen të gjitha këto? Natyrisht, jo me qëllim që të përmbysin carizmin dhe t'organizojnë triumfin e plotë të revolucionit, por që „të bajnë presion" në qeverinë cariste në mënyrë që të detyrohej me bamë reforma, me qëllim që t'a zgjanonte „konstitutën", në mënyrë që të mblidhte nji Dumë të „përmirësueme". „Aksjone revolucionare" që të reformohet sistemi i vjetër tue i ruejt klasat-kjo asht nji punë, kjo asht udha konstitucionale. „Aksjone revolucionare" që të përmbyset sistemi i vjetër, që të shpartallohet klasa sunduese-kjo asht nji gja tjeter, kjo asht udhë revolucionare e triumfit të plotë të revolucionit. Këtu qindron ndryshimi kryesor.

Ja pra, pse mendoj unë se „lufta revolucionare" që cakton Semiqi për t'a katandise çeshtjen nacionale ën

çeshtje konstitucionale nuk i përgjigjet, por vetëm e forcon deklaratën t'ime, se Semiqi „nuk e ka krejt të qartë esencën e parashtrimit bolshevik të çeshtjes nacionale" mbasi ky nuk ka kuptue se çeshtja nacionale nuk mund të shqyrtohet e veçueme, por në lidhje të pa-ndame me çeshtjen e triumfit të revolucionit, si nji pjesë e çeshtjes së përgjithëshme të revolucionit.

Me faktin se po ndalem në këtë çeshtje, natyrisht nuk kam ndër mënd të tregoj se kam thanë ndonji gja të re mi këtë gabim të Semiqit. Aspak. Mi këtë gabim ka folë shoku Manuilski që në kongresin e V-të botnuer të Kominternit tue deklarue:

> „Në broshuren e tij „çeshtja nacionale në driten e marksizmit" dhe në nji varg artikujsh që janë botue në „Radnikun", organ i PKJ, Semiqi i propozon Partisë Komuniste si zgjídhje praktike — parullen e luftes per revizion të konstitucionit, pra e katandis çeshtjen e së drejtes së vet-vendosjes së popujve ekskluzivisht në terenin konstitucional (shif stenogramet e kongresit V).

Asht e pamundun që këto vërejtje të përfaqësunsit të PKR në Komintern mbi gabimin e Semiqit të jenë bamë rastësisht dhe pa u-mbështetë gjekundi. S'ka tym pa zjarr.

Kështu qindrojnë punët me gabimin e parë, kryesor, të Semiqit.

Gabimet e tjera te tija burojnë direkt nga ky gabim kryesor.

Persa i perket çeshtjes së dytë, unë kamë provue në fjalimin t'em se Semiqi „nuk don të pfanojë se çesh-

tia nacionale n'esencen e sajë asht nji çeshtje fshatare". A asht e vertetë kjo? Lexoni, ju lutem, këtë pasazh të fjalimit të Semiqit në komisjonin jugosllav dhe çnoeni ju vetë:

„Ku qendron — pyet Semiqi — kuptimi social i çeshtjes nacionale në Jugosllavi?

Dhe pegjigjet;

„Kjo permbajtje sociale qëndron në luften e konkurences në mes kapitalit serb, në nji anë dhe të kapitalit kroat e sllloven, n'anen tjeter".

Natyrisht nuk ka asnji dyshim se lufta e konkurencës së borgjezisë kroate dhe sllovene kundra borgjezisë serbe duhet të luej nji farë roli. Por asht gjithashtu e pamohueshme se ai njeri që e shef kuptimin social të lëvizjes nacionale në luften e konkurences së borgjezive të vendeve të ndryshëm, n'esencë nuk mund t'a konsiderojë çeshtjen nacionale si çeshtje fshatare. Ku qindron sot esenca e çeshtjes nacionale, kur çeshtja nacionale nga nji çeshtje e mbrendshme lokale shtetnore u-transformue në çeshtje botnore, në çeshtjen e luftes së kolonive dhe të popujve të mëvarun kunder imperializmit. Esenca e çeshtjes nacionale tani qindron në luften e masave popullore të kolonive dhe të nacionaliteteve dipendente kundra ekspiloatimit financiar, kundra skllavrimit politik dhe privacionit kultural të këtyne kolonive dhe të këtyne nacionaliteteve nga borgjezija imperijaliste e nacionaliteteve sunduese. Ç'farë randësije mund të ketë në çeshtjen nacionale lufta e konkurences së borgjezive të ndryshme në këtë lloj paraqitjeje të çeshtjes? Sigurisht, nuk mund të ketë asnji randësi dedizive, dhe në shumë

raste bile asnji randësi esenciale. Asht krejt e qartë se këtu nuk kemi të bajmë me çeshtjen nëse borgjezija e nji nacionaliteti e thyen ose mund t'a dermojë borgjezin'e nji nacionaliteti tjeter në luften e konkurencës, por me faktin që grupet imperialiste të nacionaleve sunduese shtypin dhe ekspIloatojnë masat e gjana dhe sidomos masat fshatare të kolonive dhe të popujve dipendente dhe me faktin që, me këtë shtypje dhe ekspIloatim, i detyrojnë të futen në luftë kunder imperializmit tue i bamë aleatë të revolucjonit proletar. Çeshtja nacionale nuk mund të konsiderohet si nji çeshtje fshatare n'esencen e sajë, po qe se kuptimi social i lëvizjes nacionale katandiset në luften e konkurences së borgjezive të nacionaliteteve të ndryshme. Dhe anasjelltas: kuptimi social i levizjes nacionale nuk mund të konstatohet në luften e konkurences së borgjezive të nacionaliteteve të ndryshme, po qe se çeshtja nacionale shikohet si çeshtje fshatare n'esencen e saj. Asht e pamundun të vihet sheji i barazimit në mes këtyne dy formulave.

Semiqi i riferohet nji pjeses së broshures së Stalinit „Marksizmi dhe çeshtja nacionale" që asht shkruè nga fundi i vjetit 1912. Në këtë broshurë thuhet se „lufta nacionale asht lufta që bajnë klaset borgjeze në mes tyne." Si duket me këtë citat Semiqi do të provojë se asht i drejtë formulimi i tij mi caktimin e kuptimit social të lëvizjes nacionale në kondita të caktueme historike. Por broshura e Stalinit asht shkrue para luftes imperialiste, kur çeshtja nacionale nuk i u paraqitej marksistave si çeshtje me randësi botnore, kur pretendimi kryesuer i marksistave, persa i perket të drejtes së vetëvendosjes,

nuk paraqitej si pjesë e revolucionit proletar, por si nji pjesë e revoluçionit demokratik borgjez. Do t'ishte qesharake mos të kuptohej se që prej asaj kohe situata nderkombëtare ka ndryshue radikalisht, se lufta në nji anë, dhe n'anen tjeter revolucioni i Tetorit në Rusi, e kanë transformue çeshtjen nacionale nga nji pjesë e çeshtjes së revolucionit demokratik borgjez në nji pjesë të çeshtjes së revolucionit proletar-socialist. Që në Tetorin e vjeti 1916 Lenini tha n'artikullin e tij „Rezultatet e diskusionit mi të drejten e vetëvendosjes" se pika esenciale e çeshtjes nacionale — d.m.th. pika mi te drejten e vetëvendosjes — nuk asht ma nji pjesë e lëvizjes së pergjithëshme demokratike, por asht bamë pjesë e perbame e revolucjonit të pergjithëshem socialist-proletar. Këtu nuk do të marr në shqyrtim veprat e tjera mbi çeshtjen nacionale, si të Leninit si dhe të perfaqësuesve tjerë të komunizmit në Rusi. Ç'farë randësije mund të këtë mbas gjithë këttyneve cltimi i këtij pasazhi të broshurës se Stalinit nga ana e Semiqit, mbasi kjo broshurë asht shkrue në periudhen e revolucinit demokratik borgjez të Rusisë, — kur na, mbasi u-kriju nji situatë e re historike, hymë në nji epokë të re, n'epokën e revolucionit proletar botnuer? Kjo don të thotë vetem se Semiqi citon jashtë kohës dhe hapsinës, pa-mëvarësisht nga konstelacionet e gjalla historike, tue cenue rregullat ma elementare të dialektikes dhe tue harrue se nji gja që në nji sitiuatë historike asht e drejtë, në nji situate tjetër historike mund të bahet e gabueshme. Në fjalimin që kam mbajtë në komisjonin jugosllav, kam thanë se në trajtimin e çeshtjes nacionale nga ana e bolshevikëve rusë dallohen dy stade: stadi pari Tetorit, kur ishte çesh-

tja e revolucionit demokrat-borgjez dhe kur çeshtja nacionale konsiderohej si nji pjesë e lëvizjes së pergjithëshme demokratike, dhe stadi i Tetorit, kur ishte çeshtja e revolucionit proletar dhe kur çeshtja nacionale u-transformue në pjesë përbamëse te revollucionit proletar. Nuk asht nevojë te provohet se ky dallim ka randësi decizive. Un kam frike se Semiqi akoma nuk e ka te kjartë kuptimin dhe randësin' e këtij ndryshimi ne mes te dy stadeve në trajtimin e qeshtjes nacionale.

Prandaj un mendoj se ne tentativen e Semiqit që levizja nacionale te mos shikohet si çeshtja fshatare në esencë, por si çeshtje e luftes së konkurences së borgjezive të nacionaliteteve të ndryshme, „mëshifet ënençmimi i fuqisë së mbrendshme të lëvizjes nacionale dhe moskuptimi i karakterit thellësisht revolucionar të lëvizjes nacionale". Kështu qindron puna me gabimin e dytë të Semiqit.

Po e përsëris: nuk ka tym pa zjarr.

Ma në fund, per sa i perket çeshtjes së tretë kam thanë se Semiqi perpiqet „t'a trajtojë çeshtjen nacionale në Jugosllavi pa e lidhë me poziten internacionale dhe me perspektivat e mundshëme n'Evropë".

A asht e vertetë kjo?

Po, kjo asht e vërtetë. Pse Semiqi në fjalimin e tij nuk ka theksue aspak se pozita internacionale, në marrëdhanjet e sotëshme, paraqet faktorin ma të randësishem per zgjidhjen e çeshtjes nacionale sidomos persa i perket Jugosllavisë. Semiqi nuk i ka dhanë randësi faktit se shteti jygosllav lindi si rezultat i grindjes së dy koalicioneve të mëdha imperialiste, se Jugosllavija nuk mund

të dali nga lodra e madhe e fuqive, që bahet sot në shtetet imperialiste që e rrethojnë. Vërejtja e Semiqit pse ai parashef shum mirë disa ndryshime që mund te bahen në situaten internacionale, dhe se mbas këtyne ndryshimeve çeshtja e së drejtes së vetëvendosjes mund të bahet nji çeshtje praktike aktuale, kjo vrejtje duhet konsiderue e pamjaftueshme ne situaten e tanishme nderkombëtare. Sot nuk asht puna që të pranohet se, në rast të ndonji ndryshimi në poziten internacionale në kohen e ardhëshme, çeshtja e së drejtes së vetëvendosjes bahet aktuale — këtë nga e keqja do t'a pranoishin si perspektivë dhe demokratët borgjezë. Sot nuk asht çeshtja këtu por asht çeshtja që kufijt e sotshëm të Jugosllavisë, të krijuem me luftë dhe violencë, mos të bahen pikënisje dhe bazë e drejtë per zgjidhjen e çeshtjes nacionale. Ose — ose: ose çeshtja e së drejtes së nacioneve per vetëvendosje, d.m.th. çeshtja e ndryshimeve radikale të kufijve te Jugosllavisë asht shtesë e programit nacional, format e të cilit me mëzi arrijnë të dallohen në t' ardhmen e largët, ose asht bazë e programit nacional. Sido qoftë puna, asht krejt e qartë se pika mbi te drejten e vetëvendosjes nuk mund të jetë njikohësisht shtesë dhe bazë e programit nacional të Partis Komuniste të Jugosllavisë. Unë kam frikë se Semiqi e konsideron qjithënji të drejten e vetëvendosjes si shtesë perspektive të programit nacional.

Prandaj unë mendojë se Semiqi e ndanë çeshtjen nacionale nga çeshtja e situatës së përgjithshëme internacionale dhe se prandaj per 'te çeshtja e së drejtes së vetëvendosjes, d.m.th. çeshtja e ndryshimit të kufijve të

Jugosllavisë, n'esencë nuk asht aspak çeshtja aktuale, por çeshtje akademike.

Kështu qindron puna me gabimin e tretë të Semiqit.

Asht karakteristike se shoku Manuelski në referatin që bani në Kongresin e V-të botnuer të Kominternit, thotë po këto fjalë per gabimin e Semiqit.

„*Premisa kryesore për trajtimin e çeshtjes nacionale, siç e ven Semiqi, asht koncepti se proletariati duhet t'a shtijë në dorë shtètin borgjez të kufizuem mbrenda kufijve, që janë krijue ma luftë dhe akte violence*". (nënvizue prej J. St.)

A mund të konsiderohet kjo si nji gja e reshtit? Natyrisht, jo!

Po e persëris edhe nji herë: s'ka tym pa zjarr.

Tito:

Çeshtja nacionale në Jugosllavi në driten e luftes Nacional-Çlirimtare

Do të dëshrojsha që ky artjkull, i cili u drejtohet masave të gjana të popullit, t'u japë me kuptue gjith popujve të Jugosllavisë, randësin e madhe të luftës së sotme të madhe dhe të drejtë, dhe qi e drejtojnë prej nandëmbëdhet muejsh bijt ma të zgjedhun të popujve t'onë. Kisha me dashtë që të gjith ata, që kanë frikë për fatin e tyne dhe që tmerrohen përpara së ardhmes, të kuptojnë se vetëm nji mundësi ka drejt avenirit të tyne ma të mirë, drejt liris dhe barazis, me gjith se asht nii rrugë plot ferra, e kjo asht: lufta e sotme nacional-çlirimtare, pjesëmnrrja ne ket luftë në aradhat e Ushtris Nacional-Çlirimtare dhe Partizane të Jugosllavis. Kërkush, sot nuk duhet të ndihet i vetmuem, të friksohet nga kërcnimet e ndryshme t'atyne që në të kaluemen i kanë ba aq krime popullit t'onë, sa që ata sot nuk kan të drejt me folë n'emën të kërkujt. Vllaznimi dhe uniteti luftarak që po formohet në këte luftë të vështirë çlirimtare nga gjaku i djelmoshave të popujve t'onë, çel nji perspektivë të kjartë, se lirija dhe pamvarsija e popujve

t'onë ka me u-fitue me të vertet, se në Jugosllavi nuk do mund të ket ma shtypje nacionale di e grabitje sho q-nore.

Duket se atë qi asht e kjartë për ç'do njeri të përparuem, jo vetëm për antifashistët dhe patriotët e vendit t'onë, por edhe të të gjitha vendeve të botës ku luftohet kunder zaptuesve fashistë, nuk duen t'a kuptojnë kursesi qeveritarët jugosllavë të ikun në Londer.

Kjo asht:

Pikë se pari, kjo lufte nuk asht njisoj si lufta botnore imperialiste e kalueme, por asht nji luftë patriotike çlirimtare - lufte e drejte;

Së dyti, gati në të gjitha vendet e zaptueme, e sidomos në Jugosllavi, ket lufte kundra okupatorit nuk e drejtojnë gjeneralet dhe ministrat e ndryeshëm etj. eti., por populli vet, pa ose ku dër dëshirës së kryre gjeneralëve, oficerave dhe zotnive të tjerë trathtarë.

Së treti, ne këtë luftë çlirimtare merr pjesë Bashkimi Sovjetik që mban në shpinë të tij 90% të peshës së ksaj lufte dhe që nuk ka me lejue që frytet e ksaj lufte gjiganteske qe drejton ay, t'i korrin tradhtarët dhe reakcionarët e ndryshëm, që të mundin me shtypë përsëri popujt e tjere dhe të thurin plane per luftna të reja.

Së katërti, taman shtypja nacionale dhe mos barazija ne shum vende ka lejue qi zaptuesat fashistë të mundin lehtas disa vende.

E pesta, se „Karta e Atllantikut" nuk do të thot me zgjanue kufijt në kuriz të popujve tjerë, por do te thot nji vet-vendosje e lirë popujsh-pse në Kartën flitet që mbas fitores mbi okupatorët fashista, vetë popujt munden me zgjidhë fatin e tyne.

Në „Kartën e Atllantikut" asht arrijt në bazë t'ekspeiiencës së idhët të paqës së Versailles, e cila sidomos për popujt e Jugosllavis ka pasë konsekuenca katastrofale. Paqja e Versailles ka lind edhe ket luftë grabitëse fashiste imperialiste, luftën ma të tmerrshme që njef historija njerzore.

Por kte nuk duen me e kuptue zotnit Ministra t'ikun në Londer dhe prandaj Drazha Mihailoviqi i tyne, së bashku me vllaznit çetnikë të vet, bashkpunojnë me okupatorin, prandaj ata me asnji fjalë uuk përmendin nevojën e zgjidhjes së çështjes nacionale në Jugosllavi, por përkëndrazi kercnojnë haptazi popujt e tjere dhe thurin plane mbi zgjanimin e kufive dhe mbi hegjemonin e Serbis së madhe. Sjellja e sotshme e Drazhe Mihailoviqit me Muslimanët, me kroatët etj. i ka shkatrrue plotësisht kto plane të tyne.

E lindun ne Kerf, në London dhe Paris, Jugosllavija e Versailies asht ba vendi ma tipik i shtypjes nacionale n'Evropë. Kroatët, Sllovenët dhe malazezët kanë qenë popuj të nënshtruem, nënshtetas të pa-barabartë të robnuem dhe të nënshtruem çfarosjes, Muslimanët, pakica gjermane dhe maxhare kanë sherbye si monedh' e vogel ose si instrumenta në luftë kundra Kroatëve dhe popujve të tjerë Jugosllav.

Nji numër i vogël i pakicës së hegjemonistëve anëtarë të nji Serbie të madhe, i pa ngim në epshin e vet për pasunimin, në krye me mbretin, ka sundue 22 vjet Jugosllavin, ka krijue qeverin e gjindarmëve, regjimin e burgjeve, regjimin e padrejtsisë shoqnore dhe nacjonale. Për ç'do kërkesë të justifikueme të popujve të shty-

pun të Jugosllavis për barazim, kta zotni janë përgjegjë: „Na kemi luftue në frontin e Selanikut", Na kemi derdh gjak në Kajmakçallan", etj. Këtë rrenë te turpshme kanë përdorë kta zotni pushtët-mbajtsa, spekulatorët e ndryshëm, pasanikët e luftës dhe kuruptuesat, tue çnderue në këte mënyrë varret e shenjta të herojvet të vertet Serb — të katundarve që kanë ra theror me plot besim se po japin jeten e tyne per lirin dhe fatin e t' ardhmes së popujve Serb. Nga ana tjeter Frankistët (fashistat) e ndryshem; — Ustashet e soçëm dhe te tjerë si ata, i kanë mbështet popullit Serb punën kriminale te klikes hegjemoniste te Serbisë madhe, tue krijue n,at menyrë urejtjen e popullit Kroat dhe popujvet tjerë kundrejt popullit vlla Serb. Populli Serb jo vetem se nuk ka pasë kurgja te perbashket me nji politikë te tillë nacionale kriminale te zotnive te vet, por ai vet, gjat mbarë 22 vjetve, ka qenë gjithashtu i robnuem dhe i nenshtruem kapriçeve te gjindarmëve, siç edhe popujt e tjerë te Jugosllavis. Bile, ai, e kuptojë se qe genjye dhe se qindra mij viktimash qi dha ne luften e kalueme, kanë qenë te kota, se frytet e luftes së tij heroike i kanë pervetsue ata, qe gjat luftes rrijshin nder kafet e pllazhet e Frances, te Londres e te Svicres. Populli Serb me pikllim ka pranue shamjet dhe akuzat e pa drejta se asht bashkpuntor i bastardëve te vet per shtypjen nacionale te popujve te tjerë Jugosllavë.

politika nacionale e klikes hegjemoniste te Serbisë Madhe ka qenë:

1) Me koruptue elementat ma reakcionar te Kroatvet, te Sllovenvet, te Muslimanvet etj. tue i shfrytzue

per shpartallimin e radhëvet popullore te mbrendshme qe luftojne per te drejtat e tyne te barabarta.

2) Me korumpue krenët e Partis Sllovene, Muslimane dhe Xhemijete dhe me ndihmen e këtyne me mbajt nen thunder popullin Kroat. Me fjalë te tjera kjo donte me thanë me përça sistematikisht popujt Jugosllav, kjo donte me thanë me mbjellë urrejtjen dhe me thellue hendekun në mes të popujve vllazën të Jugosllavis. Kjo donte të thot me përça dhe jo me bashkue popujt e Jugosllavis në nji qeveri vllaznore. me të drejta të barabarta.

Fjalët e marra dhe të qindrueshme të klikës hegjemoniste, se Serbët, Kroatët dhe Sllovenët janë fise të nji populli ka pasë për qellim serbizimin e Kroatve dhe Sllovenve. Jugosllavija ka qenë vetem nji maskë për ket serbizim, e cila ka qenë zmadhue krejt në kohen e diktatures ushtarake të 6 Kallnorit të Mbretit Aleksander dhe të Péro Zhivkoviqit në vjetin 1929.

Kroatët, si nji Komb individual ma i fuqishem në mes të popujve tjerë të shtypun të Jugosllavis, kanë ba rezistencen ma të madhe kundra nji politike të tillë nacionale të Serbisë së madhe- Por kuptohet se, kjo rezistencë nuk ka muejt me bhanë ato rezultate qi priste populli Kroat. Së parit, për arsye se në krye të H. S. S. (partija katundare Kroate) kanë qenë zotni që zgjidhjen e çeshtjes nacionalë Kroate e kanë kqyrë nga pikpamja, me nda pushtetin në mes të tyne dhe zotnive Serbë të mëdhaj, me nda aferat e interesavet. Së dytit, për arsye se kta Zotnij Kroat e kanë kanalizue luften e popullit Kroat në drejtim të luftës kundra mbarë popullit Serb,

e jo vetem kundra hegjemonistave Serbë të mdhaj, që kanë mbjellë urrejtjen kunder Serbve, njisoj siç kanë mbjell Zotnit Serbë të mëdëaj kundra popullit Kroat.

Së tretit, për këtë arsye se zotnit udhëheqsa të H.S.S. kanë injorue zgjidhjen e çashtjes nacionale te popujve tjerë, si p. sh. te Sllovenve, te maqedonasve etj. Në këtë mënyrë lufta e popullit Kroat ka qindrue e izolueme jo vetem nga populli Serb por edhe nga popujt e tjerë të Jugosllavis Popujt e ndryshem të shtypun te Jugosllavis me te drejtë kanë shikue në aspiratat e Kroatve tendencën e Kroacis së madhe, tendencen e shtypjes së tjerve siç ka ba edhe klika Hegjemoniste e Serbis së madhe. Në fund si zotnit Serbë te mëdhaj si ata Kroat të H.S.S. (Hrvatska Seläčka Stranka — Partija Katundare Kroate) kanë kujtue se me anë te nji marëveshtje të thjeshte te ndamjes së pushtetit ne mes tyne, kanë me hjekë nga rendi i dites çashtjen nacionale e te gjith popujve Jugosllavë,

Deri në ç'pikë na prueni nji politikë e tillë nacjonale e pushtetit — mbajtsave Jugosllav? Kesaj pyetje i jep nji gjegje shum te kjarte katastrofa e Jugosllavis në muejin Prill të vitit 1941, kur u-zaptue vendi nga okupatorët fashista te Boshtit.

Per 22 vjet klika hegjemonjste e Serbëve të mëdhaj asht mbështet në politiken e vet anti-populllore, mbi ata që kanë qenë kumbarë të Jugosllavis së Versaljes, asht mbështetë kryesisht në reaksionin frenk si edhe në ate englez. Kurse, po sa sistemi i kalbun i Evropes së Versailjes lejoi që të ndryshojë ekuilibri i forcave imperialiste europiane, në favor të shteteve fashiste, klika re-

akcionare hegjemoniste e Serbëve të mëdhaj i drejtuekah Boshti Romë-Berlin, vetem që të ruejë hegje in e vet dhe qendrimin kundrejt popujve të tjerë të Jug-sllavis. Rasti i Stojadinoviqit, Jaftiqit, Cvetkoviqit e të tjerve e verteton bukuri kte.

Por do t'ishte e pa drejt me akuzue vetem kto personalitete reaksionare aër nji politikë të tillë antipopullore. Jo, ksaj udhe kanë hecë edhe zotnit reaksionarë Slloven në krye me Koroshecin, Natlaçen-in, Krek-un dhe të tjerët, ket rrugë kanë ndjekë zotnit reaksionarë udhëheqsa të H.S.S. ne krye me Maçek-un, Krnjeviq-in, Pernar-in e të tjerët; udhës së tillë kan hecë edhe krenët reaksionarë të Partive të ndryshme dhe te tjerë Jugosllav.

Besnike e principeve të veta, se ç'do popull ka të drejt me vendos mbi fatin e vet, Partija Komuniste, në të gjith kohen e ekzistimit të Jugosllavis, ka qindrue vazhdimisht në luftë kundra nji politikës së tillë nacionale të hegjemonistave Serbë të mëdhaj. Partija Komuniste e Jugosllavis asht çue ma me vendosmëni kundra shfrypjes së Kroatve, Sllovenve, Maqedonasve, Shqiptarëvet Malazezvet e të tjerve. Pikrisht për këtë arësye asht shtue dhe ma teper terbimi i zotnijve hegjemonista Serbë të mëdhaj kundra Partis s'onë Komuniste. Për ket arsye per 22 vjet me radhë janë mbush burgjet e Jugosllavis me luftëtarët Komunista ma të mirë, për këtë arsye edhe sot zotnit e hikun në Londër dhe agjentët e tyne në vend na urrejne për së tepermi, per ket arsye se e dijnë që lirija dhe barazija nacionale e popujve të Jugosllavis pengon krejt qellimet e tyne personale që ata të plaçkisin e të grabisin.

Okupatorët fashista Gjerman dhe Italjan kanë dijtë me shfrytzue në nji masë të gjanë kontradiktat nacjonle të ç'do vendi, kështu edhe te na në Jugosllavi. Në Çekosllovaki me te gjitha fuqitë kanë mbjellë urrejtjen në mes Çekve dhe Sllovakve, tue mobilizue reaksionarët Sllovakë në të ashtu - quejtunen Pamvarsi dhe çkëputje. Në këtë menyrë fashistat gjerman kanë arrijtë me e coptue dhe me e robnue Çekosllovakinë pa luftë.

Në Jugosllavi fashistat gjerman dhe italian kanë manovrue në mënyrë të jashtzakonshme vetëm qe t'i shfrytzojnë sa ma mirë kontradiktat nacionale dhe që të dobësojnë vendin. Nga njana anë kanë marrë nën mprojtje Paveliqin dhe bandat e pakta të tija, tue i ushqye dhe tue i dhanë mundësi vjetë me radhë me organizue në vend atentate të ndryshme nder trena e tj.; nga ana tjeter kanë lëvdue tue e ngritë deri në qiell ndër gazetat e tyne dhe ndër banketat „urtsinë" e madhe si qeveritar të Stojadinoviqit dhe të pasardhsve të tij për politikën e tyne „të urtë" dhe të vendosun, të mbrendëshme dhe të jashtme. Herë kanë lëvdue Serbët se dinë me u tregue të fuqishëm dhe dinë mos me u tërhjekun, herë kanë nxitë Kroatët mos me u tërhjekë, se kanë të drejtë n'atë ç'ka kërkojnë e tj. Qëllimi i tyne asht kenë me e shkatrrue dhe me e ligshtue gjithsesi vendin nga brenda dhe mandej me e nënshtrue. Okupatorët fashista ja kanë arrijtë kësaj. Për me realizue këtë, ata gjetën në ç'do popull të Jugosllavis mjaft trathtarë, që u ndihmuen në këte. Zgjidhja e çashtjes nacionale nga ana e fashistave asht: me gjetë në ç'do vend nji, ose disa Kuislinga, simbas numrit të nacionaliteteve, me krijue qeveri kuklle,

me e nenshtrue krejtsisht vendin ne pikpamje ekonomike dhe politike dhe me e çpall „të lirë" dhe aleat në të ashtuquejtunin rendin e ri t'Europës.

Ç'ka asht sot Paveliqi dhe banda e tij Ustashe në Kroaci? Kurgja tjetër veç se disa agjentë të thjeshtë të Kroacis së zaptueme dhe të skllavnueme. Ç'asht sot në Serbi Nediqi dhe Kompania e tij? Kurgja tjetër veç se agjentë t'okupatorit të Serbisë së zaptueme dhe të skllavnueme, Ç'asht sot ne Jugosllavi Drazha Mihailoviq dhe çetnikët e tij? Kurgja tjetër veç se agjentë dhe aleatë t'okupatorit në luftë kundra popullit. Por e tanë kjo bandë nuk paraqet vetëm agjentë por edhe gjaksorë të egjër në shërbim t'okupatorit, me ndihmën e të cilve ai çfaros pa mëshirë popujt t'onë, me ndihmën e të cilve ai përpiqet me mbajtë në sundim e robni popujt e Jugosllavis.

Nga të gjitha këto shifet se fashizmi asht anmiku ma i madh dhe ma i rrept i Liris Nacionale dhe i barazis së ç'do populli. Nga kjo rjedhë se asht e nevojshme lufta për vdekje kundra fashizmit, se asht e nevojshme lufta për vdekje kundra gjith atyne që ndihmojnë këtë fashizëm zaptues.

Lufta e sotçme Nacional-Çlirimtare dhe çashtja nanionale ne Jugosllavi janë të pandashme. Lufta e jonë Nacional Çlirimtare nuk do t'ishte aq e fuqishme dhe aq me sukses sikur popujt e Jugosllavis mos të shifshin sot në këtë luftë përveç fitores mbi fashizmin dhe fitoren mbi ata, që kanë qenë në favor të regjimëve të kalueme, fitore mbi ata, që kanë shtypë dhe aspirojnë me shtypë dhe ma gjat popujt e Jugosllavis. Fjala-luftë Nacional

Çlirimtare-do t'ishie vetëm nji frazë bile nji rrenë, sikurse ajo mos të kishte perveç vështrimit të përgjithshëm Jugosllav dhe nji vështrim nacional për ç'do popull veçmas, d. m. th. sikur ajo mos të donte me thanë veç çlirimit të Jugosllavis njikohësisht edhe çlirimin e Kroatvet, të Sllovenvet, të Serbvet, të Maqedonvet, të Shqiptarvet, të Muslimanvet etj. sikur lufta Nacional-Çlirimtare mos të kishte këtë përmbajtje, së vërtetë bjen Lirin, barazimin dhe vllaznimin e gjithë popujve Jugosllav. Në këtë qendron edhe thelbi i luftës Nacional-Çlirimtare.

Lufta e soçme Nacional-Çlirimtare nuk do të kishte marrë fund me fitimin mbi okupatorët dhe sherbetorët e tyne po që se në këtë luftë mos të kishte ekzistue bashkimi, nder radhët e Ushtris Nacional-Çlirimtare dhe Partizane të Jugosllavis, sikur mos të kishin marrë pjesë Serb, Kroat, Sllovenë, Malazez, Maqedon dhe Musliman. Nji çlirim tansuer i ç'do populli veçmas nuk do t'ishte i mundun, sikur mos të kishin marrë në dorë sot armët dhe mos të kishin shkue në luftë për nji fitore të përbashkët të gjith popujt e Jugosllavis kundra të gjith armiqve të popullit.

Penguesat kryesorë për nji unitet luftarak tansuer janë ata që shikojnë të kaluemen; të cilet dëshirojnë me vendos sistemimin e vjetër, siç ka ekzistue deri në shkatrrimin e Jugosllavis. Këta janë Kryetarët e partinave të dikurshme të ndryshme borgjeze; kjo asht e ashtuquejtuna vija e Londrës; „pritni, ende nuk ka ardh koha", asht Drazha Mihailoviq dhe çetnikët e tij, të cilët nën parullën! „Për Atme e Mbret" bajnë luftën në favor të okupatorit dhe kundra Ushtris s'onë Nacional-Çlirimtare

dhe arradhave partizane, këta janë me nji fjalë të gjith ata që kanë frikë të marri populli armët në dorë, se e dijnë se ka për të qenë at'herë e pa mundun me realizue idetë reaksionare për ndërtimin e Jugosllavis.

Prespektiva që u tregojnë popujve të Jugosllavis të ikunit në Londër asht shum e errët, dhe paraqet nji rrezik të tmerrshëm për të gjith ata popuj qi kanë qenë të shtypun që nga krijimi i Jugosllavis. Kërbaçi i gjindarmve dhe kamxhiku i çetnikve do t'ishte mjeti kryesuer i kësaj qeverije t'aratisun në Londër për me bashkue popujt e Jugosllavis, sikur të mirrte përsëri, për fat të keq, fuqin në Jugosllavi.

Maqedonët, Shqiptarët, Kroatët, Muslimanët etj. me frikë pyesin veten - ç'ka me ndodhë me ne po qe se do të kthehet përsëri ajo e vjetra? Qeverija e hikun në Londër qysh tash kërcnon; çetnikët qysh tash therin ku munden me ndihmën e okupatorit dhe mprehin thikat për nji kasaphanë edhe ma të madhe - për këtë friksohen të gjith popujt. Por na u themi të gjithve, mos të friksohen, shpëtimi nga të gjith këta asht i mundun dhe asht vetëm ky, po qe se qysh sot me nji herë, pa kursye, rroket pushka dhe shkohet në luftën e shenjtë që ban Ushtrija e jonë trime Nacional - Çlirimtare kundra okupatorit, për lirin dhe barazin e të gjith popujve të Jugosllavis.

Duhet të nënvizoj ktu faktin se ne radhët e Ushtris s'onë popullore - çlirimtare dhe partizane të Jugosllavis qysh në fillim e deri më sot gjinden ma tepër Serbë, në vend qi të jet e kunderta. Shif Brigadat partizane Serbe, malazeze, boshnjake dhe të Likës, të cilat kanë qenë të formueme gati krejt prej Serbësh, kanë luftue dhe luf-

tojnë edhe sot jo vetëm kundra okupatorit, por, edhe kundra qetnikve të Drazha Mihailoviqit dhe kundra anmiqve te tjerë të popujve të sntypun. Ç'ka na tregon kjo? Kjo na tregon se të gjith popujt ë Jugosllavis qi kanë qenë dikur të shtypun nga hegjemonistat Serbë te mëdhaj kanë si aleatin ma të mirë dhe ma besnik Popullin Serb. Populli Serb ka dhanë dhe jep gjithnji kontributin ma te madh gjaku në luftë kundra okupatorit dhe kundra sherbëtorve të tyne, tradhtarë jo ve'em kundra Paveliqit, Nediqit, Peqancit, por edhe kundra Drazhe Miaihlloviqit dhe çetnikve te tij, për lirin dhe pamvarsinë e plotë të të gjith popujve te Jugosllavis, Populli serb nuk deshiron gjithashtu qi të kthehet ajo e vjëtra, siç nuk e deshrojnë kte as Kroatet, as Sllovenët, as Malazezët, as Muslimanët. Populli Serb e din fare mirë pse asht mbrijtë deri ne nji tragjedj te tillë, kush asht aty fajtori kryesor, dhe prandaj ai lufton kaq heroikisht dhe urren tradhtaret e Atdheut të vet. Prandaj detyra e shenjtë e te gjith popujve te Jugosllavis asht qi të marrin pjesë ne këtë luftë të madhe çlirimtare s'pakut po aq, në mos edhe ma teper, s'bashkut me popullin Serb, kundra okupatorit dhe gjith sherbetorve të tij.

Flamuri i luftes nacional çlirimtare kundra okupatorit, që asht ngrit nga Partija Komuniste e Jugosllavis me 1941 asht njikohsisht edhe flamuri i luftës per lirin dhe barazin nacionale te ç'do populli veçmas; ky asht po ay flamur, qi Partija Komuniste e Jugosllavis e mban te papërkulun qysh me krijimin e Jugosllavis, tue luftue pa kompromisë per lirin dhe barazin nacionale te të gjith popujve te Jugosllavis. Partija Komuniste nuk e ka brak-

tisë dhe nuk ka me braktisë kurr principin e vet, i cili asht vendos nga mësuesat dhe udhëheqsat t'onë të mdhaj-Lenini dhe Stalini, e kjo asht me i dhanë te drejtë ç'do populli me vetvendosë për çkëputjen. Por bashkë me ktë Partija Komuniste e Jugosllavis nuk ka me lejue kurrsesi qi anmiqt e popujve t'a shfrytëzojnë këte te drejtë dhe ne vend të Liris dhe të pamvarësisë te formojne per popullin errsinën e mesjetës dhe robnin koloniale, si asht rasti me kroacin „e pamvarun" te Paveliqit. Partija Komuniste e Jugosllavis ka me luftue edhe ma gjat per bashkimin vllaznor, te lirë dhe të barabartë te te gjith popujvę te Jugosllavis. Ka me luftue njisoj kundra hegjemonistave Serbë të mëdhaj te cilet aspirojnë me shtypë përsëri popujt e ndryshem te Jugosllavis, gjithashtu ka me luftue kunder atyne që, për interesat e asaj ase kësaj fuqije imperialiste kanë me u mundue me mbjellë perçamje dhe kanë me pengue dashunin vllaznore të popujve të Jugosllavis.

Çashtja e Maqedonis, çashtja e Kosovës dhe e Metohis, çashtja e Malit të Zi, çashtja e Kroacis, çashtja e Sllovenisë, çashtja e Bosnjës dhe e Hercegovinës ka me u-zgjidhë lehtë tue i kënaqë përgjithësisht të gjith, vetëm në këtë mënyrë që populli do t'a zgjidhi vetë, dhe ç'do popull e fiton këte të drejtë në kët luftë të sotme popullore-çlirimtare me pushkë në dorë.

VENDIM

i mbledhjes së dytë të Keshillit Antifashist të Jugosllavis per ndertimin e Jugosllavis në parimin federativ

Në bazë të së drejtës së vet-vendosjes të secilit popull, tue permbajtë të drejten për çkëputje ase bashkim me popuj tjerë, dhe në pajtim me dëshirën e vërtetë të të gjithë popujve të Jugosllavis, të dishrueme gjatë luftës trevjeçare të përbashkët Nacional-Çlirimtare e cila e ka farkue vllaznimin e pathyeshem të popujve të Jugosllavis, Këshilli Antifashist i Çlirimit kombtar të Jugosllavis merr këte

Vendim:

1) Popujt e Jugosllavis kurr nuk e kanë pranue dhe nuk pranojnë ndamjen e Jugosllavisë nga ana·e imperjalistave fashistë, por kanë tregue në luftën e perbashkët deshiren e tyne të pa perkulshme që të jenë këndej e tutje të bashkuem në nji Jugosllavi.

2) Që të realizohet parimi i sovranisetit të popujve të Jugosllavisë, në mënyrë që Jugosllavija të prezantojë atdheun e vërtetë të popujve të vet dhe që kurr mos të jetë vend dominimi i çfaredo qoftë klike hegjemoniste, Jugosllavija po ndertohet me parim federativ që do t'u sigurojë të drejtat barabarta të plota Serbëve,

Kroatëre, Sllovenëve, Maqedonasve dhe Malazezve, d.m.th. popujve të Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bosnjes e Herçegovinës,

3) Në pajtim me ndertimin e tillë federativ të Jugosllavis, i cili bazohet në të drejtat ma të plota demokratike vertetohet se edhe sot në kohen e luftës Nacional-Çlirimtare, pushteti populluer i popujve të ndryshëm të Jugosllavis prezantohet nga Komiteti Nacional Çlirimtare dhe Këshillat Antifashiste të Çlirimit Kombtar të vendit (Komiteti Kryesuer i Çlirimit Kombtar të Serbis, Këshilli Antifashist i çlirimit Kombtar të vendit të Kroacicë. K.Ç. K. i Sllovenis; K. Ç. K. për Bosne e Sercegovinë, K.Ç.K. për Mal të Zi dhe Bokë; K.A.Ç K. për Sanxhak, Organet inisjative të K.A.Ç.K. për Maqedoni) dhe se Këshill Antifashist i Çlirimit Kombtar të Jugnsllavis asht trupi perfaqësues suprem legjislativ dhe ekzekutiv i popujve të Jugosllavis dhe perfaqësues suprem i sovranitetit të popujve dhe shtetit të Jugosllavis si tanësi.

4) Pakicave Kombtar në Jugosllavi do t'u sigurohen të gjitha të drejtat nacionale.

5) Ky vendim hyn menjiherë në fuqi.

Jajce, me 29 Nanduer 1943.

PER KESHILLIN ANTIFASHIST TE ÇLIRIMIT KOMBTAR TE JUGOSLLAVIS

Sekretari:
Rodolub Çollakoviq ,d. v.

Kryetari:
Dr. Ivan Ribar, d. v.

Rade Pribiqeviq

Lufta e jone Nacional-Çlirimtare dhe sistemi federativ

Çeshtja kombtare dhe zgjedhja e sajë janë të lidhuna shum ngushtë me luften e të tanë koalicjonit anti Hitlerjan, nga nji anë, dhe në luften e vetë popujve t'onë nga ana tjeter.

Pan-gjermanizmi dhe imperializmi i Hiterit, që bazohet në teorin e superioritetit racjal te races nordike, që t'a themi praktikisht, gjermane, si „zotnues" kishte per qellim të shtinte nen zgjedhë të tanë Europen e, prej andej mbarë boten. Degradimi i popujve të robnuem në gjendjen e skllavëvet kolonjalë, detyra e të cilëve do t'ishte që t'i jepshin industris gjermane dhe ekonomis gjermane, pergjithsisht landet e para dhe fuqi të lirë puntore, kolonizimin e vendeve ma të begatëshme të Europes, në rend të parë Ukrainës dhe çfarosjen e banorëve të sajë; çdukja e të gjitha lirivet (mendimit, ndergjegjës etj) dhe i të gjitha vlerave kulturore; burgjet e trekambshat, gazet helmuese dhe pyjet e Katynit; — kjo ka qenë perspektiva e ërrët e dominacjonit hitlerjan dhe e „rendit të tijë të ri n'Europë.

I trimnuem nga fitoret e lehta n'Europë, Hitleri në sulmin kundra B.R.S.S.-it hasi në nji bllok të çelikt popujsh të lirë e të lumtun. Qëndresa e fortë e Bashkimit Sovjetik ka qenë themeli i krijimit dhe perforcimit

të koalicjonit anti-hitlerjan Angli, Amerikes dhe Bashkimit Sovjetik, që u ka dhanë popujve të robnuem besimin në çlirimin e tyne dhe në nji ardhmëni ma të mirë.

Sukseset e mëdha t'Aleatve, veçanërisht t'Ushtris së Kuqe, fitoret e së cilës kanë sjellë nji kthim në të tanë këte luftë, përfunduen në realizime të mëdha politiko-diplomatike, që u kunorzuen në Konferencat e Moskës e të Teheranit. Nder këto konferenca, jo vetem që asht caktue afati dhe shtrijësija e operacioneve aleate nga lindja, jugu e perendimi, jo vetem që asht vendosë denimi i të gjithë kriminelave të luftës, por janë theksue e nenvizue veçanërisht dekllaratat e ma parëshme që popujt vet do të vendosin mbi fatin e tyne, që ata vet do t'i rregullojnë punët e tyne të mbrendëshme, gja që ka shpartallue shprasat e zaptuesavet fashista mbi mundësinë e nji perçamjeje, bile edhe prishjes së aleances ndërmjet kombeve li i dashës,

Konkluzat e konferencave të Moskes e të Teheranit jehuen thellë në zemrat e të gjithë popujve të robnuem të mëdhaj e të vegjel, që vuejnë nën skllavënin hitlerjane për fajin dhe trathtinë e qeveritarëve kunder populluer dhe të kollonës së pestë. Ato janë pershndet sidomos nga popujt t'onë të cilët gjatë tri vjetve perpjekjesh dhe vuejtjesh mbi njerzore, u bashkuen, formuen ushtrin e admirueshme dhe të pa thyeshme dhe vet çliruen pjesën ma të madhe të vendit të tyne. Konkluzat e ketyne konferencave u garantojne popujve t'onë që frytet e kësaj lufte dhe fitoret e mëdha do t'i gëznjnë vet popujt t'onë dhe askush tjeter.

Pran laj lufta Nacional Çlirimtare nuk ka per qe-

llim vetem permbysjen e fashizmit. Ajo asht guri themeltar i çlirimit të vertetë, të drejtave të barabarta dhe jeteses së lumtun të popujve të Jugosllavis.

Popuj të ndryshëm mund të qëndrojnë në nji shetet ja me forcë, ja me dëshiren e tyne të lirë.

Jugosllavija e vjeter ka qenë shembulli i grumbullimit të popujve. Popujt t'onë kanë dishirue me shekuj, herë ma pak e herë ma teper, të bashkoheshin në nji shtet por asnji nder ta, bile as populli Serb, në kurriz të të cilit klika hegjemoniste e Serbve të mëdhej ka dashtë me e ngarkue pergjegjsinë e shtypjes kombtare, nuk e ka dashtë nji asi shteti, siç ka qenë Jugosllavija e vjeter.

Qeverimi ishte çentralist, por çentralizimi, në nji shtet shum kombsinash, don të thotë qeverim më dhunë sepse, ja sundon nji popull, ja se n'emën të tijë bahet shtypja e të tjerëve, gja që sjellë si rrjedhim që edhe ay popull „zotnues" pa tjeter t'a humbasi lirin në bazë të parimit të njoftun që nji popull, i cili shkelë të tjerët, nuk mund të jetë as vet i lirë. Kështu tek na, n'emen të popullit serb dhe në bazë të tezes së rrejshme të popullit me tre emna, me ndihmen e partive reaksjonare të popujve tjerë, hegjemonistat serb të mëdhaj pa pikë turpí i çuen në vend interesat e tyne te ngushta dhe vetjake, ndersa të gjithë popujt t'onë mbeten pothuej në nji skllavëni të barabartë dhe u mbyten n'errësinen e tiranisë e të shtypjes së diktatures ushtarake mbretnore.

Qeveritarët e njerzit e kolones së V-të të Jugosllhvis së vjetër ua çelen deren hap e krah eksponentave fashista dhe me 25 Mars 1941 nënshkruen Paktin e Tripalshit, sepse në fashizmin dhe reaksjonin nderkomb-

tare ata shifshin aleatin natyral kundra popujve të tyne. Prej këndej, asht logjike (si vazhdim i politikes së tyne anti-popullore njizet vjeçare) që, në këte perpjekje titanike tri vjeçare të popujve t'onë per jetë e liri, ata nuk kanë ndejtë n'anen e popullit, por n' anen e zaptuesit; tue pasë në krye të dy fytyrat që i karakterizojnë, dy perfaqsuesit të tyne — Nediqin e Mihajloviqin.

Njizet e shtat Marsi 1941 asht shprehja e pezmatimit dhe deshires së popullit per luftë dhe tregon se popujt t'onë e kishin vendosë nji herë e mirë me ja hye luftes së madhe vendimtare per liri e pamvarësi.

Hovi luftarak i popujve t'onë, i ndrydhun gjatë njizet vjetësh tiranije, u thye nga paniku dhe mos-zotsija e qeveris dhe trathtija e gjeneralëve, kështu që, per disa ditë vendi i ynë kapitulloi, jo i mundun, por i trathtuem e i mashtruem.

Në saje të udhëheqjes së Partis Komuniste, që i ftoi në kryengritje, popujt t'onë shpetuen nga çfarosja.

Kryengritja ka qenë sidomos shpetimi per Serbët në pashallekun e Paveliqit që, perndryshej, do të asgjasoheshin deri në njeriun e fundit.

Popujt t'onë po krijojnë ushtrin e madhe moderne nji tip të ri ushtrijet, të ndertuem si mbas parimit të mobilizimit e të fornizimit të vet-vullnetshëm, mbas parimit t'armatosjes me armët e anmikut. Heroizmin dhe vuejtjet e ushtris s'onë ka per t'i shenjue historija si nji nder realizimet ma të mëdhaja të vullnetit njerzuer dhe të shpirtit njerzuer, jo vetem historija e jonë, por edhe historija botnore.

Fitimet ma të mëdhaja të luftës s'onë nuk janë

gjithaqë zonat e mëdhaja që janë çlirue se sa vllaznimi e bashkimi luftarak i popujve t'onë, si bazë e Jugosllavis së re. Që t'a perkthejmë në gjuhën politike, kto fitime gjeten shprehjen e tyne nder konkluzat historike të mbledhjes së dytë të Këshiflit Anti-fashist të çlirimit kombtar të Jugosllavis, mbi krijimin e Jugosllavis demokratike federative. Ky asht suksesi i ynë politik ma i madh dhe nji heroizm e re e fuqishme per luftë deri në çlirimin e plotë.

Popuj të ndryshëm mund të jetojnë në nji bazë të bashkimit të lirë, vetem në nji komunitet shtetnuer federativ, mbassi në nji komunitet të këtillë çdo popull vendosë mbi çeshtjen e vet, njisin e vet të ngushtë, ndersa të gjithë bashkë kujdesohen dhe zgjidhin çeshtjet e perbashkëta.

Në nji komunitet federativ çdo popull asht i lirë me i rregullue vet punët e veta por deri sa nuk e cenon tanësinë, por, kur jetesa bjen ne kundershtim me tanësin, ajo duhet t'i nënshtrohet kësaj, sepse interesi i tanësis ja kalon interesit të njisive, veç e veç, dhe sepse, në fund të të fundit, interesi i tanësis don të thotë edhe interesi i pjesëve.

Nga ana tjeter sigurimi i komunitetit e banë të mundëshem zhvillimin e lirë dhe sigurimin e pjesëve. Prandaj projtja e komunitetit asht detyra dhe interesi i parë i të gjitha pjesëve së bashkut.

Prej këndej, féderata parqet ekuilibrin në mes të liris dhe të sigurimit. Zaten ajo dhe të thotë jo vetëm identitet i interesave të nji populli dhe njisis tijë të veçantë federative, por identitet interesash të të gjithë popujve së bashku dhe të tanë komunitetit shtetnuer federativ.

Parimi Federativ paraqet parimin ma demokratik, mbassi çdo pupull, per çashtjet e tija të veçanta, ka organe të tija të veçanta të pushtetit legjislativ, ndersa per çeshtje te pergjithëshme të komunitetit, ka organe të perbashkëta

Prandaj, nuk mund të ketë vend as per sypermi as per shtypje.

Në revolucjonin e Madh të Tetorit në ish Rusin, triumfoi parimi federativ dhe u ndertue B.R.S.S.. Qe proklamue parimi i vet-vendosjes deri në çkëputje, por kurkush nuk u çkëput, dhe të gjithë jetojnë në komunitetin e lirë, tue e ruejt ate si driten e syvet, tue i dhanë shembullin e admirueshem mbar botës se si 200 popuj mund të jetojnë në nji shtet, si në familje.

Deri sa Rusija cariste ka qenë burgu, të cilit i vinte era gurë dhe B.R.S.S. asht shtepija shkrojtore dhe e bukur plot ajr dhe dritë ku sejcili e ka banesen e vet dhe të gjithë ndertojnë të njejtin kulm. Anglo — Saksonët natyritht mbi baza të tjera asht zbatue parimi i organizmit federativ të shtetit dhe parimi i vet qeverimit dhe bash kësaj gjaje ju detyrojnë në nji masë të gjanë realizimet e tyne të mëdhaja politike-kulturore.

Mbas sistemit federativ Serbët që jetojnë në Kroaci duhet të hyjnë në njisinë federative kroate. Dikush pyet se çffarë ka me qenë njisija e tyne. Pa dyshim se ata do të kene të drejte të barabarta. Vepra e kryengritjes dhe e luftës çlirimtare asht veper e perbashkët e Serbëve, Krottëve dhe të gjithë popujve t'onë. Pa njeni tjetrin ata nuk do të mujshin me ba kurgja kurse të gjithë së bashkut kanë ba mrekullina. Lufta e perbashkët, gjaku i shtrejtë që kanë derdhë dhe vorret e ndritëshme të kë-

saj lufte të shejt patriotike që u kanë dhanë popujve t' onë bindjen e thellë se vetëm bashkimi i ka shpëtue dhe se ai edhe do t'i mbajë.

Institucjoni demokratik-federativ i Jugosllavis do japë të drejta të barabarta ehhe pakicave jo sllave. Si nuk do t'i siguroka, atëherë të drejtat e baraqarta Serbit në Kroaci ase kroatit-Bunjevcit në Vojvodinë? Mbi të gjitha njisit fedevative do të mbretnojë shpirti i komunitetit, i cili, si nji nanë e mirë, do të rrijë gjithmonë zgjuet e do të kujdesohet që të gjitë djemt e vet t'a duen, mbrojnë e t'a ndihmojnë njani tjetrin, mbasi ky asht kushti i lumnis dhe perparimit të tanë komunitetit.

Së mbrami, popujt t'onë do të hecin me hapa gjigande nepër rrugen e gjanë të ditunisë dhe të mirëqenjes, kështu që rrezja e arsimit do t'i shëndrisi edhe çeshtjet e ërrëta ku akoma mund të fshihen farët e së kaluemes dhe të mos kuptimit.

Lufta e jonë Nacional-Çlirimtare i shpëtoi popujt t'onë, ua farkoi dhe ua çelnikosi shpirtin e tyne, i mbëlodhi të gjithë lumejt e vegjel në shtratin e nji lumi të fuqishëm në siperfaqen e lëmuet të të cilit, të rrahun nga drita e diellit, anija lavdi plotë e popujve t' onë lundron drejtë fitores, ardhëmenis e lumnis.

Po te mos ishte lufta Nacional-Çlirimtare, zaptuesi me anen e trathtarëve t'onë, do të na asgjasonte; vetem se do të çfarosëshin ndermjet vedi, per kënaqsinë ma të madhe të zaptuesit hitlerjanë dhe botes nuk do të mujshin me i tregue kurgja tjeter. Kjo do t'ishte e tmerrshme, porse edhe fati i ynë nuk do të mallëngjente kerkend-

Por, në saje të luftës dhe të Ushtris Nacional — Çlirimtare, popujt t'onë po i çfaqen botes si simbol he roizmi dhe vullnet - krijues. Ata, jo vetem mbrojnë dhe-po ndertojnë shtëpin e tyne' por po apin kontributin e tyne edhe n'altarin e liris dhe të lumtunis së mbarë njerzimit. Dhe madhnija e popujvet nuk matet vetem mbas asajë se sa kanë ba per vedi, por edhe se sa i kanë ndihmue liris dhe perparimit te njerzimit mbarë.